



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
DREJTORIA E BUXHETIT DHE MENAXHIMIT FINANCIAR

RAPORTI I MONITORIMIT TË BUXHETIT

PËR

4 MUJORIN E PARË TË VITIT 2024

PËRMBAJTJA

1- HYRJE

1.1 Misioni i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë

1.2 Fushat e Përgjegjësisë Shtetërore

1.3 Programet Buxhetore

2- INFORMACION BUXHETOR I AGREGUAR

3- PERFORMANCA E TREGUESVE KYÇ TË PËRFORMANCËS ME BAZË GJINORE NË NIVEL PRODUKTI

4- PERFORMANCA E BUXHETIT NË NIVELIN E PROGRAMIT

4.1 Performanca Financiare e Programit Buxhetor

4.2 Performanca Jo Financiare e Programit Buxhetor

4.3 Veprimet vijuese në Nivelin e Programit Buxhetor

5- PROJEKTET KAPITALE

6- NDRYSHIMET NË BUXHET

7- PËRFUNDIME

1. HYRJE

1.1 MISIONI

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë ka si mision hartimin e zbatimin e politikës së përgjithshme shtetërore në sektorin e planifikimit dhe të zhvillimit urban, në sektorin e infrastrukturës e të transportit, në sektorin e telekomunikacionit dhe të shërbimit postar, në sektorin e energjisë, të shfrytëzimit të burimeve energjetike e minerare, si dhe në sektorin e industrisë. Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë është përgjegjëse për hartimin dhe ndjekjen e zbatimit të masave për eliminimin e pasojave dhe rindërtimin e objekteve të dëmtuara e të shkatërruara nga fatkeqësia natyrore, tërmeti i datës 26.11.2019.

1.2 FUSHAT E PËRGJEGJËSISË SHTETËRORE

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë e ushtron veprimtarinë e saj në zbatim të VKM-së nr.111, datë 02.03.2022 "Për përcaktimin e fushës së përgjegjësive shtetërore të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë" (i ndryshuar).

1.3 PROGRAMET BUXHETORE

Në zbatim të ligjit 97/2023 "Për Buxhetin e vitit 2024", MIE menaxhon 11 programe buxhetore si vijon:

1. Transporti Rrugor
2. Transporti Detar
3. Transporti Hekurudhor
4. Transporti Ajror
5. Furnizim me Ujë dhe Kanalizime
6. Mbështetje për Energjinë
7. Mbështetje për Burimet Natyrore
8. Mbështetje për Industrinë
9. Mbështetje për Rrjetet e Komunikacionit
10. Planifikim Urban
11. Planifikim Menaxhim Administrim

Në zbatim të ligjit 97/2023 "Për Buxhetin e vitit 2024", buxheti 2024, për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë ishte në vlerën 52,777,485,000 lekë, i detajuar sipas shpenzimeve:

- Shpenzime korrente 5,672,929,000 lekë
 - Shpenzime kapitale 47,104,556,000 lekë
- nga të cilat:*
- *shpenzime kapitale me finance të brendshëm* 27,660,492,000 lekë
 - *shpenzime kapitale me financim të huaj* 19,444,064,000 lekë

Miratimi i detajimit fillestar nga Ministria e Financave, u bë pjesor në vlerën 52,405,857,332 lekë si vijon:

- Shpenzime korrente 5,672,929,000 lekë
 - Shpenzime kapitale 46,732,928,332 lekë
- nga të cilat:*
- *shpenzime kapitale me financim të brendshëm* 27,288,864,332 lekë
 - *shpenzime kapitale me financim të huaj* 19,444,064,000 lekë

Miratimi i buxhetit fillestar, u bë me një diferencë buxhetore, në vlerën prej 371,667,668 lekë, në shpenzimet kapitale të programit buxhetor "Furnizimi me Ujë dhe Kanalizime". Diferenca buxhetore, u miratua nga Ministria e Financave me shkresën nr.1391/3 prot., datë 10.05.2024.

Plani i buxhetit për vitin 2024 për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë arriti në vlerën 57,142,245,000 lekë, gjatë 4- mujorit të I, 2024. Plani pësoi ndryshime në kuadër të:

- ✓ rishikimit të buxhetit me Aktin Normativ nr.1, datë 21.02.2024 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.97/2023 "Për buxhetin e vitit 2024" në vlerën 57,137,485,000 lekë me të dhënat si vijon:

- Shpenzime korrente 5,802,929,000 lekë
 - Shpenzime kapitale 51,334,556,000 lekë
- nga të cilat:*
- *shpenzime kapitale me finance të brendshëm* 37,490,492,000 lekë
 - *shpenzime kapitale me financim të huaj* 13,844,064,000 lekë

- ✓ alokimi i fondit të veçantë në vlerën 4,760,000 lekë.

Nga ndryshimet e sipërcituara të buxhetit 2024, rezultuan shtesa dhe pakësimet në nivel klasifikimi buxhetor si vijon:

- Shpenzimet korrente, u shtuan në vlerën 130,000,000 lekë;
- Shpenzimet kapitale me financim të brendshëm u shtuan në vlerën 9,830,000,000 lekë;
- Shpenzimet kapitale me financim të huaj, u pakësuan në vlerën 5,600,000,000 lekë.

2. INFORMACION BUXHETOR I AGREGUAR

Plani fillestar i buxhetit, plani i rishikuar dhe realizimi faktik për periudhën e 4 Mujorit të I, për vitin 2024, në nivel programi buxhetor, paraqitet si në tabelën më poshtë:

Emri i Grupit		Ministria e Infrastruktures dhe Energjise		Kodi i grupit		06	
		Plani Fillestar Vjetor Viti 2024	Plani Vjetor i Rishikuar Viti 2024	Shpenzime Faktike të Periudhës Progressive	Realizimi ne %		
Shpenzimet sipas programeve buxhetore							
Kodi i Programit	Emërtimi	Vlera ne leke	Vlera ne leke	Vlera ne leke	ne %		
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	669,101,000	670,208,230	219,273,660	32.70		
04320	Mbështetje per Energjinë	3,243,156,000	3,243,582,870	469,460,087	14.50		
04430	Mbështetje për Burimet Natyrore	390,081,000	391,681,000	93,301,686	23.80		
04440	Mbështetje për Industrinë	413,631,000	414,087,500	128,536,722	31.00		
04520	Transporti Rrugor	23,083,544,000	24,084,041,800	4,024,523,586	16.70		
04540	Transporti Detar	8,814,439,000	10,044,759,000	39,901,202	0.40		
04550	Transporti Hekurudhor	4,277,348,000	5,277,448,800	463,343,502	8.80		
04560	Transporti Ajror	27,030,000	27,030,000	9,908,169	36.70		
04610	Mbështetje për rrjetet e komunikacionit	120,000,000	120,000,000	0	0.00		
06180	Planifikimi Urban	196,263,000	196,413,000	40,838,543	20.80		
06370	Furnizimi me uje dhe kanalizime	11,171,264,332	12,301,365,132	2,191,077,500	17.80		
Totali i Shpenzimeve buxhetore te Ministrise (Kap 01,02,03,04,05,)		52,405,857,332	56,770,617,332	7,680,164,657	13.50		
Shpenzime nga te Ardhurat Jashte limitit (Kap 06)				12,549,831			
Totali Shpenzimeve te Ministrisë				7,692,714,488			

Në tabelën më lartë dhe kudo në këtë dokument, plani fillestar vjetor 2024 dhe plani vjetor i rishikuar 2024, **ka një diferencë prej 371,627,668 lekë** me ligjin e miratuar të buxhetit 2024 (i ndryshuar), që lidhet me shpenzimet kapitale me financim të brendshëm të programit buxhetor "Furnizimi me Ujë dhe Kanalizime". Miratimi i detajimit nga MF për diferencën, u bë me shkresën nr.1391/3prot., datë 10.05.2024.

Nga sistemi AFMIS, në gjenerimin e Aneksit 1 "Raporti përmbledhës i shpenzimeve të Ministrisë", konstatohet se pjesë e listës së programeve buxhetore, është edhe programi "Menaxhimi i Mbetjeve Urbane", me shpenzime faktike të raportuara në vlerën 6,354,610 lekë. Theksojmë se në zbatim të ligjit nr.97/2023 "Për Buxhetin e vitit 2024" (të ndryshuar), si dhe tabelave nr.1, nr.1.1, nr.1.2, shoqëruese të ligjit, programi "Menaxhimi i Mbetjeve Urbane", nuk është pjesë e strukturës së programeve buxhetore të MIE.

Plani fillestar i buxhetit, plani i rishikuar dhe realizimi faktik për periudhën raportuese për vitin 2024, sipas klasifikimit ekonomik, paraqiten si në tabelën më poshtë:

Emri i Grupit		Ministria e Infrastruktues dhe Energjise		Kodi i grupit		06	
		Plani Fillestar Vjetor Viti 2024	Plani Vjetor i Rishikuar Viti 2024	Shpenzime Faktike të Periudhës Progressive	Realizimi ne %		
Shpenzimet sipas klasifikimit ekonomik							
Artikulli	Emërtimi	Vlera ne leke	Vlera ne leke	Vlera ne leke	ne %		
600	Paga	1,429,353,000	1,519,353,000	420,548,090	27.70		
601	Sigurime Shoqërore	255,103,000	265,103,000	68,909,484	26.00		
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	3,051,673,000	3,080,185,000	636,643,948	20.70		
603	Subvencione	850,000,000	850,000,000	158,248,000	18.60		
604	Transferta Korente të Brendshme	0	0	0	0.00		
605	Transferta Korente të Huaja	46,000,000	46,000,000	22,843,954	49.70		
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ	40,800,000	47,048,000	26,760,205	56.90		
	Nen-Totali Shpenzime Korrente	5,672,929,000	5,807,689,000	1,333,953,681	23.00		
230	Kapitale të Patrupëzuara	570,956,000	574,188,206	42,295,128	7.40		
231	Kapitale të Trupëzuara	26,717,908,332	36,544,676,126	5,066,550,957	13.90		
	Nen-Totali Shpenzime Kapitale me financim te brendshem	27,288,864,332	37,118,864,332	5,108,846,086	13.80		
230	Kapitale të Patrupëzuara	284,213,000	284,213,000	160,896,280	56.60		
231	Kapitale të Trupëzuara	19,159,851,000	13,559,851,000	1,076,468,610	8.00		
	Nen-Totali Shpenzime Kapitale me financim te huaj	19,444,064,000	13,844,064,000	1,237,364,890	9.00		
	Totali Shpenzime Kapitale	46,732,928,332	50,962,928,332	6,346,210,976	12.50		
	Totali i Shpenz. Buxhetore te Ministrise/Institucionit Buxhetor	52,405,857,332	56,770,617,332	7,680,164,657	13.50		
	Shpenzime nga te Ardhurat Jashte limitit (Kap 06)			12,549,831			
	Totali (Korrente + Kapitale + Shpenz. nga te ardh. jashte limti)			7,692,714,488			

Për sa më lartë, rezulton se realizimi i fondeve buxhetore për 4 mujorin e parë të vitit 2024 kundrejt planit të rishikuar të buxhetit 2024, **është 13.4%**. Krahasuar me realizimin e fondeve buxhetore për të njëjtën periudhë të vitit 2023, e cila ishte në masën prej **23.4%**, evidentohet një rënie e realizimit buxhetor prej **10%**. Në nivel klasifikimi buxhetor, të dhënat krahasuese të realizimit buxhetor në % midis dy periudhave janë:

	4-mujori I 2023	4 mujori I 2024
✓ Shpenzimet korrente	25.9%	23%
✓ Shpenzime kapitale	23.1%	12.5%
<i>nga të cilat :</i>		
○ Shpenzime kapitale me financim të brendshëm	33.6%	13.8%
○ Shpenzime kapitale me financim të huaj	7.7%	9%

Realizimi buxhetor i shpenzimeve korrente, ruan të njëtin nivel realizim në vlerë nominale prej 1,3 miliard lekësh krahasuar me të njëjtën periudhën të vitit 2023.

në / 000 lekë

Shpenzimet Korrente	Viti 2023	Viti 2024
✓ Plani vjetor i rishikuar	5,357,940 lekë	5,807,689 lekë
✓ Realizimi buxhetor 4 mujor	1,389,106 lekë	1,333,954 lekë

Realizimi buxhetor i shpenzimeve kapitale me financim të brendshëm nuk ruan të njëtin nivel me periudhën krahasuese për arësyetimet si vijonë:

në / 000 lekë

Shpenzimet Kapitale FB	Viti 2023	Viti 2024
✓ Plani vjetor i rishikuar	24,494,294 lekë	37,490,492 lekë
✓ Realizimi buxhetor 4 mujor	9,909,106 lekë	5,108,846 lekë

Shpenzime kapitale me financim të brendshëm (buxheti i rishikuar) për vitin 2024, janë rritur me 7,996,198,000 lekë ose me 27% krahasur me vitin 2023. Kjo rritje në nivel programi përbëhet nga:

- Pakësim i tavanit buxhetor në programin e transportit rrugor prej 988 milion lekë krahasuar me periudhën referuese 2023. Në buxhetin 2024, projektet e reja që janë në procedurë prokurimi përbëjnë 31.5% të tavanit buxhetor për këtë program, ku krahasuar me periudhën referuese 2023, projektet e reja përbënin vetëm 18.3% të tavanit buxhetor, të programit. Për vitin 2024 projektet e reja që janë në procedurë prokurimi përbëjnë 79% të tavanit buxhetor për ARRSH brenda programit të transportit rrugor, krahasuar me periudhën referuese 2023 që përbënin 50%;
- Pakësimi i tavanit buxhetor në pogramin e transportit ajror prej 2 miliard lekë, krahasuar me periudhën referuese 2023;
- Rritja e tavanit buxhetor në programin e transportit detar prej 9.8 miliard lekë krahasuar me periudhën referuese 2023. Kjo shtesë e tavanit buxhetor lidhet me projektin e ri strategjik kombëtar "Porti i ri Tregtar i Integruar i Durrësit në Porto Romano-Faza 1", i buxhetuar në vlerën 9.8 miliard lekë

- Kritja e tavanit buxhetor në programin "Furnizimi me Ujë dhe Kanalizime" prej 2,3 miliard lekë, krahasuar me periudhën referuese 2023. Në buxhetin 2024, projektet e reja që janë në procedurë prokurimi përbëjnë 27% të tavanit buxhetor për këtë program ku krahasuar me periudhën referuese 2023, projektet e reja përbënin vetëm 11% të tavanit buxhetor të programit.

Realizimi buxhetor i shpenzimeve kapitale me financim të huaj është 1% më i lartë në vitin 2024, por më i ulët në vlerë nominale krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2023.

në / 000 lekë

Shpenzimet Kapitale FF	Viti 2023	Viti 2024
✓ Plani vjetor i rishikuar	19,909,755 lekë	13,844,064 lekë
✓ Realizimi buxhetor 4 mujor	1,537,700 lekë	1,243,720 lekë

Shpenzime kapitale me financim të huaj për vitin 2024 janë pakësuar me 6,065,691,000 lekë ose me 30% krahasuar me vitin 2023.

Lidhur me rialokimet buxhetore për 4-mujorin e parë 2024, në nivel klasifikimi buxhetor japim shpegimet si vijon:

- Për shpenzimet korrente janë kërkuar nga MIE dhe janë miratuar nga MF, 4 procedura rialokimesh:
 - Miratuar nga Ministria e Financave, në muajin shkurt, transferim për pagesat e telefonisë celulare të funksionarëve publike, në vlerën totale 1,488,000 lekë, në zbatim të VKM nr.763, datë 02.09.2020 "Për paisjen me numër telefoni të funksionareve publike për institucionet, për programet buxhetore:
 - "Planifikim, menaxhim, administrimi"
 - "Mbështetje për Energjinë"
 - "Transporti Ajror"
 - "Planifikimi Urban"
 - "Mbështetje për Burimet Natyrore"
 - Miratuar nga Ministria e Financave në muajin mars 2024, transferimi i fondeve buxhetore në vlerën 14,350,000 lekë, për programin buxhetor "Planifikim,menaxhim, administrimi", për planifikimin e fondeve buxhetore për Qendrën Rajonale të Inovacionit në zbatim të VKM nr.697, datë 06.12.2023 "Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Qendrës Rajonale të Inovacionit të Institutit Evropian të Teknologjisë dhe Inovacionit për Lëndët e Para (EIT Raë Materials Regional Innovation Center).

- Miratuar nga Ministria e Financave në muajin prill 2024, transferimi i fondit të veçantë, në vlerën 30,000 lekë, në zbatim të VKM nr. 929, datë 17.11.2010 "Për krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë" (të ndryshuar) për programin buxhetor "Planifikim, Menaxhim, Administrimi";
 - Miratuar nga Ministria e Financave në muajin prill 2024, transferimi i fondit të veçantë, në vlerën 60,000 lekë, për programin buxhetor "Transporti Rrugor".
- Për shpenzimet kapitale me financim të brendshëm janë kërkuar nga MIE dhe janë miratuar nga MF 3 procedura rialokimesh:
- Miratuar në muajin prill, saktësimi i kodit të institucionit, në programin "Planifikimi Urban";
 - Miratuar në muajin prill, saktësimi i llogarisë ekonomike, në programin "Transporti Detar";
 - Miratuar në muajin prill, saktësimi i emërimit të projekt investimit, në programin "Furnizimi me Ujë dhe Kanalizime".
- Për shpenzimet kapitale me financim të huaj, është kërkuar nga MIE dhe është miratuar nga MF, 1 procedurë rialokimi:
- Miratuar në muajin prill, transferimi i fondeve buxhetore me financim të huaj, në vlerën 700,000 lekë, në programin "Transporti Detar"

Në zbatim të ligjit 97/2023 "Për Buxhetin e vitit 2024", numri maksimal i punonjësve i miratuar për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, ishte 1,168 punonjës.

Në zbatim të Aktit Normativ nr.1, datë 21.02.2024 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.97/2023 "Për buxhetin e vitit 2024", numri maksimal i punonjësve të miratuar për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë u bë 1,216 punonjës, me një rritje prej 48 punonjësish. Kjo rritje e numrit të punonjësve lidhet me strukturën e Task Forcës të ngritur pranë AKUK, në zbatim të Aktit Normativ nr.8, datë 28.12.2023 "Për marrjen e masave urgjente, për mbrojtjen dhe përmirësimin e infrastrukturës, për trajtimin e ujërave të ndotura që shkarkohen pranë ose në ujëra larëse".

Në tabelën më poshtë paraqiten numri maksimal i punonjësve të shpërndarë në organikat e njësive shpenzuese të varësisë si dhe numri i punonjësve të pashpërndarë për organikat e reja të pazbardhura, por të miratuara me ligjet përkatëse.

Ministria e Infrastruktues dhe Energjise

Detajimi i Numrit të Punonjësve Buxhetorë për vitin 2024

Entiteti Qeverisjes	Ministria Linjës	Kodi i Inst.	Emër institucioni	Kapitulli	Llogaria Ekonomike	Kodi Thesarit	Numri i punonjësve të miratuar me ligjin 97/2023	Numri i punonjësve të miratuar me ligjin 97/2023 (i ndryshuar)
001	06	1006001	Aparati i MIE	01	PN0000	3535	248	248
001	06	1006047	Agjencia Kombëtare e Ujësjellës-Kanalizimeve	01	PN0000	3535	49	49
001	06	1006047	Task- Forca "Për marrjen e masave urgjente për mbrojtjen dhe përmirësimin e infrastrukturës së ujrave të ndotur që derdhen në ujëra larës"	02	PN0001	3536		48
001	06	1006054	Autoriteti Rrugor Shqiptar	01	PN0000	3535	112	112
001	06	1006079	Drejtoria e Rajonit Qëndër Perendim (Tiranë)	01	PN0000	3535	41	41
001	06	1006077	Drejtoria e Rajonit Verior (Shkodër)	01	PN0000	3333	47	47
001	06	1006067	Drejtoria e Rajonit Jugor (Gjirokastrë)	01	PN0000	1111	41	41
001	06	1006200	Drejtoria e Rajonit Qëndër Lindje (Korçë)	01	PN0000	1515	45	45
001	06	1006099	Instituti Transportit	01	PN0000	3535	15	15
001	06	1006098	Drejtoria e Përgjithshme Detare	01	PN0000	0707	70	70
001	06	1006100	Autoriteti Sigurisë Hekurudhore	01	PN0000	0707	17	15
001	06	1006143	Autoriteti Kombëtar i Investigimit për Sigurinë e Operimit në Aviacionin Civil	01	PN0000	3535	8	8
001	06	1006161	Arkivi Qëndror Teknik i Ndërtimit	01	PN0000	3535	21	21
001	06	1006155	Agjencia Kombëtare Bërthamore	01	PN0000	3535	7	7
001	06	1006157	Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial	01	PN0000	3535	200	199
001	06	1006158	Agjencia Kombëtare për Sigurinë dhe Emergjencat në Miniera	01	PN0000	3535	47	47
001	06	1006156	Shërbimi Gjeologjik Shqiptar	01	PN0000	3535	116	116
001	06	1006159	Qendra e Grumbullimit dhe Trajtimit të Kimikateve të Rrezikshme	01	PN0000	0808	13	13
001	06	1006164	Agjencia Eficencës Energjisë	01	PN0000	3535	20	20
001	06	1006187	Agjencia Shtetërore për Shpronësimin	01	PN0000	3535	27	27
001	06	1006203	Qendra Rajonale e Inovacionit te Institutit Evropian te Teknologjise dhe Inovacionit per Lendet e Para	01	PN0000	0808	3	8
Totali							1,147	1197
Numri punonjësve i pashpërndarë								
001	06	I ri	Autoriteti Rregullator Hekurudhor	01	PN0000	3535	9	6
001	06	I ri	Organi Kombëtar i Investigimit të Aksidenteve Hekurudhore dhe Detare	01	PN0000	3535	12	12
Totali							21	
TOTAL MIE							1,168	1,215

3. PERFORMANCA E TREGUESVE KYÇ TË PËRFORMANCËS ME BAZË GJINORE NË NIVEL PRODUKTI

Objekti i politikës së programit "Planifikimim, Menaxhim, Administrim", është mirëmenaxhimi i stafit të Aparatit MIE dhe politikëbërja me sukses brenda fushës së përgjegjësive shtetërore, duke respektuar parimin e barazisë gjinore dhe mos diskriminimin. Treguesit më kryesor të performancës me bazë gjinore renditen:

✓ Forcimi kapaciteteve administrative nëpërmjet trajnimeve të ndryshme për punonjësit e administratës	50%
✓ Rritja e standardeve në punë	60%
✓ Gra të përfaqësuara në nivele të larta drejtuese të Aparatit të MIE	4
✓ Raporti gra / ndaj totalit të punonjësve të Aparatit të MIE	132
✓ Raporti burra / ndaj totalit të punonjësve të Aparatit të MIE	67

Programi "Mbështetje për Rrjetet e Komunikacionit", përfshin si tregues të performancës rritjen e penetrimit dhe përdorimit të infrastrukturës digjitale broadband që i shërben përfshirjes sociale dhe barazisë gjinore.

Në veçanti, projekti i parashikuar për investime në fibrat optike në zonat e bardha, parashikon të mbulojë me shërbime dhe infrastrukturë digjitale, zonat e pambuluara/pa shërbyera nga sektori privat duke rritur potencialisht mundësinë e përfshirjes sociale, të punësimit, dhe zvogëlimin të ndarjes digjitale gjinore. Gjithashtu projekti i parashikuar për sigurimin e mbulimit me Wi-Fi në zonat publike i shërben lehtësimit të aksesimit në TIK dhe shërbimet publike për të gjithë banorët/qytetarët në zonat e thella.

Referuar të dhënave më të fundit statistikore, shkalla e përdorimit të TIK, dhe në veçanti e Internetit në vend është si më poshtë:

- Përdorues të Internetit - Gjatë vitit 2023, 84,6 % e burrave dhe 81,7 % e grave të grup-moshës 16-74 vjeç janë përdorues të internetit "gjatë 3 muajve të fundit".
- Shpeshësia e përdorimit të internetit sipas ndarjes gjinore, tregon se përdorimi i internetit "disa herë gjatë ditës" dominohet nga burrat me 50,3 %, ndërsa përdorimi i tij "çdo ditë" dominohet nga gratë me 53,3 %.¹
- Të punësuar në sektorin e telekomunikacionit - në vitin 2022 ndarja sipas gjinisë për të punësuarit në sektorin e telekomunikacionit ishte 27,8 % gra dhe 72,2 % burra.

Gjatë periudhës së monitorimit nuk është e mundur të matet ndryshimi për këta tregues sepse jepet me bazë vjetore sipas të dhënave të raportuara nga AKEP, INSTAT.

4. PERFORMANCA E BUXHETIT NË NIVELIN E PROGRAMIT

4.1 PERFORMANCA FINANCIARE E PROGRAMIT BUXHETOR

4.1.1 Programi Buxhetor "Planifikim Menaxhim Administrim"

Realizimi financiar i programit buxhetor "Planifikim Menaxhim Administrim" sipas burimit të financimit dhe në nivel klasifikimi buxhetor rezulton të jetë:

	Plani fillestar 2024	Plani rishikuar 2024	Realizimi në lekë	Realizimi në%
Shpenzime korrente	656,101,000	657,208,230	219,273,660	33.3%
Shpenzime kapitale FB	13,000,000	13,000,000	0	0%
Shpenzime kapitale FH	0	0	0	0%

Shpenzimet korrente në program shërbëjnë për mirëfunksionimin e aktivitetit operacional të dy institucioneve të varësisë:

- ✓ Aparati i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë;
- ✓ Qendra Rajonale e Inovacionit

Në shpenzimet korrente të programit, plani i rishikuar 2024 ka një rritje prej 1,107,230 lekë që vjen nga rialokimi i fondit të veçantë. Si më poshtë vijon, paraqiten të dhënat krahasuese për realizimin financiar për të njëjtën periudhë të vitit 2023. Rezulton se për 4-mujorin e parë të vitit 2024 ka një realizim më të lartë si në vlerë nominale ashtu edhe në %:

në / 000 lekë

Shpenzimet Korrente	Realizimi Financiar Viti 2023	Realizimi Financiar Viti 2024
Artikulli 600	78,684 lekë	104,885 lekë
Artikulli 601	13,014 lekë	16,725 lekë
Artikulli 602	12,252 lekë	49,017 lekë
Artikulli 605	29,223 lekë	22,844 lekë
Artikulli 606	19,991 lekë	25,801 lekë
TOTALI	153,164 LEKË	219,274 LEKË
REALIZIMI NË%	28.3%	33.3%

Në shpenzimet kapitale të programit nuk ka realizim në produkte dhe në financim, kjo pasi janë projekte të reja 2024. Për këto projekte po hartohen termat e referencës me qëllim vijimin e procesit të prokurimit.

në / 000 lekë

Shpenzimet Kapitale FB	Realizimi Financiar Viti 2023	Realizimi Financiar Viti 2024
Artikulli 231	0 lekë	0 lekë

Në muajin mars 2024, është miratuar nga Ministria e Financave, transferimi i fondeve buxhetore në vlerën 14,350,000 lekë, për programin buxhetor për planifikimin e fondeve buxhetore për Qendrën Rajonale të Inovacionit në zbatim të VKM nr.697, datë 06.12.2023 “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Qendrës Rajonale të Inovacionit të Institutit Evropian të Teknologjisë dhe Inovacionit për Lëndët e Para (EIT Raë Materials Regional Innovation Center).

Artikulli 602, i Aparatit MIE është vendosur në sekuestro konservative për shlyerje të detyrimeve gjyqësore të formës së prerë. Në databasën e vendimeve gjyqësore të Aparatit MIE, janë të regjistruara për vitin 2024, detyrime në vlerën 1,823,700,000 lekë.

Artikulli 606, i Aparatit MIE "Rimbursim i shpenzimeve të varrimit për shtetasit shqiptare që vdesin jashtë vendit", kërkon fonde shtesë në vlerën 56.000.000 për periudhën e mëtejshme të vitit buxhetor 2024. Financimi për 4 mujorin e parë të vitit 2024, është realizuar në masën 324 praktika, prej të cilave 84 praktika ishin të mbartura nga vitet e mëparëshme (mungesë dokumentacioni) dhe 240 dosje të ardhura gjatë 4 mujorit të parë të vitit 2024.

4.1.2 Programi Buxhetor "Planifikimi Urban"

Realizimi financiar i programit buxhetor "Planifikimi Urban", sipas burimit të financimit dhe në nivel klasifikimi buxhetor rezulton të jetë:

	Plani fillestar 2024	Plani rishikuar 2024	Realizimi në lekë	Realizimi në%
Shpenzime korrente	92,263,000	92,413,000	21,493,888	23.2%
Shpenzime kapitale FB	104,000,000	104,000,000	19,344,655	18.6%
Shpenzime kapitale FH	0	0	0	0%

Shpenzimet korrente në program shërbëjnë për mirëfunksionimin e aktivitetit operacional të dy institucioneve të varësisë:

- ✓ Arkivi Qëndror Teknik i Ndërtimit
- ✓ Agjensia Shtetërore e Shpronësimeve

Në shpenzimet korrente të programit, plani i rishikuar 2024 ka një rritje prej 150,000 lekë që vjen nga rialokimi i fondit të veçantë. Si më poshtë vijon, paraqiten të dhënat krahasuese për realizimin financiar për të njëjtën periudhë të vitit 2023. Rezulton se për 4-mujorin e parë të vitit 2024 ka një realizim më të lartë në vlerë nominale, por jo në %, kjo sepse plani i rishikuar 2024 është më i lartë se plani i rishikuar 2023 me një shtesë prej 18 milion lekë:

në / 000 lekë

Shpenzimet Korrente	Realizimi Financiar Viti 2023	Realizimi Financiar Viti 2024
Artikulli 600	12,489 lekë	16,240 lekë
Artikulli 601	1,974 lekë	2,658 lekë
Artikulli 602	3,617 lekë	2,596 lekë
Artikulli 605		
Artikulli 606	12 lekë	0 lekë
TOTALI	18,092 LEKË	21,494 LEKË
REALIZIMI NË%	24.4%	23.3%

Realizimi i shpenzimeve kapitale të programit paraqitet si vijon në periudhat krahasuese, rezulton se për vitin 2024 ka një realizim më të lartë si në vlerë nominale, ashtu dhe në %.

në / 000 lekë

Shpenzimet Kapitale FB	Realizimi Financiar Viti 2023	Realizimi Financiar Viti 2024
Artikulli 231	0 lekë	19,345 lekë
REALIZIMI NË%	0%	18.6%

Për shpenzimet kapitale me financim të brendshëm në muajin prill 2024 është kërkuar nga MIE dhe është miratuar nga MF, 1 procedurë për saktësim të kodit të institucionit.

Shpenzimet kapitale të programit realizohen nga 2 njësi shpenzuese të varësisë dhe një Bashki si vijon: Përgjithësisht në projektet me realizim financiar 0 lekë për 4 mujorin e parë të vitit 2024, janë duke u hartuar termat e referencës që të vijojë më pas procedura e prokurimit.

- ✓ Aparati i Ministrise së Infrastruktues dhe Energjisë, me plan të shpenzimeve kapitale prej 60.5 milion lekë për implementimin e 4 projekteve;
- ✓ Arkivi Qendror Teknik i Ndërtimit, me plan të shpenzimeve kapitale prej 1.5 milion lekë për implementimin e 1 projekti;
- ✓ Bashkia Fier, me plan të shpenzimeve kapitale prej 42 milion lekë për zërin shpronësime në zbatim të VKM nr.125, datë 03.03.2021.

4.1.3 Programi Buxhetor "Mbështetje për Rrjetet e Komunikacionit"

Realizimi financiar i programit buxhetor "Planifikimi Urban", sipas burimit të financimit dhe në nivel klasifikimi buxhetor rezulton të jetë:

	Plani fillestar 2024	Plani rishikuar 2024	Realizimi në lekë	Realizimi në%
Shpenzime korrente	0	0	0	0%
Shpenzime kapitale FB	100,000,000	104,000,000	0	0%
Shpenzime kapitale FH	20,000,000	20,000,000	0	0%

Projektet kapitale paraqiten si më poshtë:

Gjatë 4 mujorit të parë të vitit 2024 programi buxhetor "Mbështetje për Rrjetet e Komunikacionit" për shpenzimet kapitale me financim të brendshëm nuk ka realizim financiar për periudhën e raportimit, ndërsa shpenzimet kapitale me financim të huaj kanë realizim të aktiviteteve në masën 30% dhe realizim financiar 0% sipas informacionit më poshtë:

Shpenzimet kapitale me financim të brendshëm:

- WBIF -Asistencë teknike- Projekti pilot 2 për zonën e jugut, buxheti i rishikuar është në vlerën 12.000.000 lekë dhe realizimi financiar është në masën 0%, pasi financimi i projektit lidhet me realizimin e projektit të EBIF -Asistencë teknike.
- Zhvillimi i marrëveshjes Shqipëri-Kosovë mbi Autostradën Digjitale 5G Prishtinë-Tiranë, buxheti i rishikuar është në vlerën 5.000.000 lekë dhe realizimi financiar është në masën 0% pasi investimi nuk ka filluar ende.
- Zbatimi i kuadrit ligjor për komunikimet elektronike, buxheti i rishikuar është në vlerën 2.000.000 lekë dhe realizimi financiar është në masën 0% pasi projekti nuk ka filluar ende, pritet miratimi i ligjit nga Kuvendi.
- Plani i Komunikimit/Promovimi për zbatimin e ligjit të ri të komunikimeve elektronike, buxheti i rishikuar është në vlerën 1.000.000 lekë dhe realizimi financiar është në masën 0%, pasi projekti nuk ka filluar ende, pritet miratimi i ligjit nga Kuvendi.
- WiFi4AL, buxheti i rishikuar është në vlerën 55.000.000 lekë dhe realizimi financiar është në masën 0%, pasi projekti nuk ka filluar ende, është në proces përgatitje.
- Implementimi (Upgrade) i ATLAS - last mile, buxheti i rishikuar është në vlerën 5.000.000 lekë dhe realizimi financiar është në masën 0%, pasi projekti nuk ka filluar ende.
- Programi Digjital i BE-së, buxheti i rishikuar është në vlerën 20.000.000 lekë dhe realizimi financiar është në masën 0%, por projekti është në proces përgatitje të planit të komunikimit.

Shpenzimet kapitale me financim të huaj:

- WBIF -Asistencë teknike- Projekti pilot 2 për zonën e jugut, buxheti i rishikuar është në vlerën 20.000.000 lekë dhe realizimi financiar është në masën 0%, por projekti ka filluar dhe aktualisht realizimi i aktiviteteve të projektit është 30%. Është dorëzuar raporti fillestar dhe rishikimi i raportit ligjor dhe rregullator.

4.1.4 Programi Buxhetor "Transporti Ajror"

Realizimi financiar i programit buxhetor "Transporti Ajror", sipas burimit të financimit dhe në nivel klasifikimi buxhetor rezulton të jetë:

	Plani fillestar 2024	Plani rishikuar 2024	Realizimi në lekë	Realizimi në%
Shpenzime korrente	25,030,000	25,030,000	9,908,169	39,7%
Shpenzime kapitale FB	2,000,000	2,000,000	0	0%
Shpenzime kapitale FH	0	0	0	0%

Në shpenzimet korrente të programit, plani i rishikuar 2024, nuk ka ndryshim nga plani fillestar. Si më poshtë vijon, përcjellim të dhënat krahasuese për realizimin financiar për të njëjtën periudhë të vitit 2023. Rezulton se për 4-mujorin e parë të vitit 2024, ka një realizim më të lartë si në vlerë nominale ashtu edhe në %:

në / 000 lekë

Shpenzimet Korrente	Realizimi Financiar Viti 2023	Realizimi Financiar Viti 2024
Artikulli 600	1,962 lekë	4,391 lekë
Artikulli 601	266 lekë	715 lekë
Artikulli 602	0 lekë	4,788 lekë
Artikulli 605	0 lekë	0 lekë
Artikulli 606	0 lekë	14 lekë
TOTALI	2,228 LEKË	9,908 LEKË
REALIZIMI NË%	10.9%	39.6%

Shpenzimet korrente në program shërbëjnë për mirëfunksionimin e aktivitetit operacional të Autoritetit Kombëtar të Investigimit për Sigurinë e Operimit në Aviacionin Civil.

Në shpenzimet kapitale të programit nuk ka realizim në produkte dhe në financim, kjo pasi janë projekte të reja 2024. Për këto projekte po hartohen termat e referencës me qëllim vijimin e procesit të prokurimit.

në / 000 lekë

Shpenzimet Kapitale FB	Realizimi Financiar Viti 2023	Realizimi Financiar Viti 2024
Artikulli 231	0 lekë	0 lekë

Në këtë program Akisa ka përcjellë kërkesa shtesë në shpenzimet kapitale në vlerën 3.2 milion lekë për projektin "Blerje pajisje për çantën e investigatorit".

4.1.5 Programi Buxhetor "Mbështetje për Industrinë"

Realizimi financiar i programit buxhetor "Mbështetje për Industrinë", sipas burimit të financimit dhe në nivel klasifikimi buxhetor rezulton të jetë:

	Plani fillestar 2024	Plani rishikuar 2024	Realizimi në lekë	Realizimi në%
Shpenzime korrente	335,631,000	336,087,500	115,438,921	34.3%
Shpenzime kapitale FB	78,000,000	78,000,000	13,097,801	16,8%
Shpenzime kapitale FH	0	0	0	0%

Në shpenzimet korrente të programit, plani i rishikuar 2024 ka një rritje prej 456,500 lekë që vjen nga riallokimi i fondit të veçantë. Si më poshtë vijon, përcjellim të dhënat krahasuese për realizimin financiar për të njëjtën periudhë të vitit 2023. Rezulton se për 4-mujorin e parë të vitit 2024, ka një realizim më të lartë si në vlerë nominale ashtu edhe në %:

në / 000 lekë

Shpenzimet Korrente	Realizimi Financiar Viti 2023	Realizimi Financiar Viti 2024
Artikulli 600	67,045 lekë	87,807 lekë
Artikulli 601	11,191 lekë	14,567 lekë
Artikulli 602	12,119 lekë	12,889 lekë
Artikulli 605	0 lekë	0 lekë
Artikulli 606	96 lekë	176 lekë
TOTALI	90,451 LEKË	115,439 LEKË
REALIZIMI NË%	31%	34.3%

Shpenzimet korrente në program shërbëjnë për mirëfunksionimin e aktivitetit operacional të dy institucioneve të varësisë:

- ✓ Inspektoriat Shtetëror Teknik Industrial
- ✓ Qendra e Grumbullimit, Trajtimit të Kimikateve të Rrezikshme

Realizimi i shpenzimeve kapitale të programit paraqitet si vijon në periudhat krahasuese. Rezulton se për vitin 2023 ka një realizim më të lartë si në vlerë nominale, ashtu dhe në %.

në / 000 lekë

Shpenzimet Kapitale FB	Realizimi Financiar Viti 2023	Realizimi Financiar Viti 2024
Artikulli 231	15,610 lekë	13,098 lekë
REALIZIMI NË%	18,6%	16,8%

Shpenzimet kapitale të programit realizohen nga 4 njësi shpenzuese të varësisë si vijon. Për projektet që nuk kanë realizim financiar ende, po hartohen termat e referencës për të vijuar procedurat e prokurimit/apo janë zhvilluar aktivitetet e projektit dhe janë në procedurë financimi.

- ✓ Inspektoriat Shtetëror Teknik Industrial, me një plan të shpenzimeve kapitale prej 57.5 milion lekë për implementimin e dy projekteve;
- ✓ Qendra e Grumbullimit, Trajtimit të Kimikateve të Rrezikshme, me një plan të shpenzimeve kapitale prej 4.1 milion lekë për implementimin e 4 projekteve;
- ✓ Uzina e Plehrave Azotike me një plan të shpenzimeve kapitale prej 5.45 milion lekë për fonde konservimi dhe për ruajtjen dhe monitorimin e 2 landfilleve të mbetjeve të rrezikshme;
- ✓ Ndërmarrja e Prodhim Celiqeve Elbasan, me një plan të shpenzimeve kapitale prej 10.95 milion lekë për fonde konservimi.

4.1.6 Programi Buxhetor "Mbështetje për Burimet Natyrore"

Realizimi financiar i programit buxhetor "Mbështetje për Burimet Natyrore", sipas burimit të financimit dhe në nivel klasifikimi buxhetor rezulton të jetë:

	Plani fillestar 2024	Plani rishikuar 2024	Realizimi në lekë	Realizimi në%
Shpenzime korrente	293,081,000	294,681,000	75,441,837	25.6%
Shpenzime kapitale FB	97,000,000	97,000,000	17,859,849	18,4%
Shpenzime kapitale FH	0	0	0	0%

Në shpenzimet korrente të programit, plani i rishikuar 2024 ka një rritje prej 1,600,000 lekë që vjen nga rialokimi i fondit të veçantë. Si më poshtë vijon, përcjellim të dhënat krahasuese për realizimin financiar për të njëjtën periudhë të vitit 2023. Rezulton se për 4-mujorin e parë të vitit 2024, ka një realizim më të lartë si në vlerë nominale ashtu edhe në %:

	<i>në / 000 lekë</i>	
Shpenzimet Korrente	Realizimi Financiar Viti 2023	Realizimi Financiar Viti 2024
Artikulli 600	45,070 lekë	57,829
lekë		
Artikulli 601	7,542 lekë	9,466 lekë
Artikulli 602	6,811 lekë	7,513 lekë
Artikulli 605	0 lekë	0 lekë
Artikulli 606	108 lekë	634 lekë
TOTALI	59,531 LEKË	75,442 LEKË
REALIZIMI NË%	24,7%	25.6%

Shpenzimet korrente në program shërbëjnë për aktivitetin operacional të dy institucioneve të varësisë:

- ✓ Shërbimi Gjeologjik Shqiptar;
- ✓ Autoriteti Kombëtar për Sigurinë dhe Emergjencat në Miniera

Realizimi i shpenzimeve kapitale të programit paraqitet si vijon në periudhat krahasuese. Rezulton se për vitin 2023 ka një realizim më të lartë si në vlerë nominale, ashtu dhe në %. Për vitin 2024 plani buxhetor i rishikuar ka një rritje me 6 milion lekë krahasuar me planin buxhetor të rishikuar të vitit 2023.

në / 000 lekë

Shpenzimet Kapitale FB	Realizimi Financiar Viti 2023	Realizimi Financiar Viti 2024
Artikulli 231	20,910 lekë	17.860 lekë
REALIZIMI NË%	23%	18.4%

Shpenzimet kapitale të programit realizohen nga 7 njësi shpenzuese të varësisë si vijon:

- ✓ Shërbimi Gjeologjik Shqiptar, me plan të shpenzimeve kapitale prej 4 milion lekë për implementimin e 1 projekti;
- ✓ Autoriteti Kombëtar për Sigurinë dhe Emergjencat në Miniera, me plan të shpenzimeve kapitale prej 13.5 milion lekë për implementimin e 3 projekteve;
- ✓ Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, me plan të shpenzimeve kapitale prej 45,1 milion lekë për implementimin e 7 projekteve;
- ✓ Sekretariati i Nismës për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse -EITI, me plan të shpenzimeve kapitale prej 14 milion lekë për funksionimin e saj;
- ✓ Shoqëria në konservim “Albakër” sh.a. me plan të shpenzimeve kapitale prej 7 milion lekë për fonde konservimi
- ✓ Shoqëria në konservim “Albminiera” sh.a. me plan të shpenzimeve kapitale prej 6.8 milion lekë për fonde konservimi;
- ✓ Shoqëria në konservim “Albkrom” sh.a. me plan të shpenzimeve kapitale prej 6.6 milion lekë për fonde konservimi

4.1.7 Programi Buxhetor "Transporti Detar"

Realizimi financiar i programit buxhetor "Transporti Detar", sipas burimit të financimit dhe në nivel klasifikimi buxhetor rezulton të jetë:

	Plani fillestar 2024	Plani rishikuar 2024	Realizimi në lekë	Realizimi në%
Shpenzime korrente	154,439,000	154,759,000	37,807,180	24.4%
Shpenzime kapitale FB	50,000,000	9,880,000,000	1,506,252	0,02%
Shpenzime kapitale FH	8,610,000,000	10,000,000	587,770	5.9%

Në shpenzimet korrente të programit, plani i rishikuar 2024 ka një rritje prej 320,000 lekë që vjen nga riallokimi i fondit të veçantë. Si më poshtë vijon, paraqiten të dhënat krahasuese për realizimin financiar për të njëjtën periudhë të vitit 2023. Rezulton se për 4-mujorin e parë të vitit 2024, ka një realizim më të lartë në vlerë nominale.

në / 000 lekë

Shpenzimet Korrente	Realizimi Financiar Viti 2023	Realizimi Financiar Viti 2024
Artikulli 600	23,691 lekë	30,674 lekë
Artikulli 601	3,963 lekë	5,063 lekë
Artikulli 602	1,494 lekë	2,069 lekë
Artikulli 605	0 lekë	0 lekë
Artikulli 606	159 lekë	0 lekë
TOTALI	29,307 LEKË	37,807 LEKË
REALIZIMI NË%	24,8%	24.4%

Shpenzimet korrente në program shërbëjnë për mirëfunksionimin e aktivitetit operacional të Drejtorisë së Përgjithshme Detare.

Tavani buxhetor i shpenzimeve kapitale ka pësuar ndryshime gjatë periudhës së 4-mujorit të parë 2024, në zbatim të Aktit Normativ nr.1, datë 21.02.2024 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.97/2023 "Për buxhetin e vitit 2024" ndryshimet konsistojnë në:

- ✓ Shpenzimet kapitale me financim të brendshëm **u rritën** me 9,830,000,000 lekë;
- ✓ Shpenzimet kapitale me financim të huaj **u pakësuan** me 8,600,000,000 lekë.

Ky ndryshim në tavanin buxhetor të shpenzimeve kapitale lidhet drejtpërdrejtë me implementimin e projektit të ri strategjik kombëtar "Porti i Ri Tregtar i Integruar i Durrësit në Porto Romano-Faza 1", i buxhetuar në vlerën 9.8 miliard lekë (20% e vlerës së projektit).

Realizimi i shpenzimeve kapitale me financim të brendshëm të programit ka një realizim më të lartë në vlerë nominale, por jo në % krahasuar me periudhën referuese të vitit 2023. Për vitin 2024 plani buxhetor i rishikuar ka një rritje me 9,8 miliard lekë, krahasuar me planin buxhetor të rishikuar të vitit 2023.

në / 000 lekë

Shpenzimet Kapitale FB	Realizimi Financiar Viti 2023	Realizimi Financiar Viti 2024
Artikulli 231	1,390 lekë	1,506 lekë
REALIZIMI NË%	2.4%	0,02%

Shpenzimet kapitale me financim të brendshëm të programit realizohen nga 4 njësi shpenzuese të varësisë si vijon:

- ✓ Aparati i Ministrise se Infrastruktures dhe Energjise, me plan të shpenzimeve kapitale prej 19,4 milion lekë për implementimin e 2 projekteve me realizim financiar të periudhës 0%;
 - Oponencë teknike për projektin “Ndërtimin dhe mirëmbajtjen e Portit të Integruar në Triport, Vlorë;
 - Shërbime inxhinierike të pavarura për zbatimin e kontratës koncesionare “Për projektimin, ndërtimin dhe mirëmbajtjen e Portit të Integruar në Triport, Vlorë
- ✓ Drejtoria e Përgjithshme Detare Durrës, me plan të shpenzimeve kapitale prej 26,4 milion lekë për implementimin e 3 projekteve;
- ✓ Autoriteti Portual Durrës, me plan të shpenzimeve kapitale prej 9,83 miliard lekë për implementimin e e projektit "Porti i Ri Tregtar i Integruar të Durrësit në Porto Romano- Faza 1". Ende nuk ka filluar procedura ndërkombëtare e prokurimit, për arsye të akteve të tjera nënligjore që lidhen me VKM për shpronësimet dhe VKM për ekspertizën e pavarur, të cilat priten të finalizohen brenda muajit Maj 2024;
- ✓ Ndërmarrja e Shfrytëzimit Ujor Vau Dejës, me plan të shpenzimeve kapitale prej 3,87 milion lekë për fonde konservimi;

Realizimi i shpenzimeve kapitale me financim të huaj të programit ka një realizim më të lartë në vlerë nominale, dhe në % krahasuar me periudhën referuese të vitit 2023

në / 000 lekë

Shpenzimet Kapitale FH	Realizimi Financiar Viti 2023	Realizimi Financiar Viti 2024
Artikulli 231	0 lekë	588 lekë
REALIZIMI NË%	0%	5.9%

Shpenzimet kapitale me financim të huaj të programit realizohen nga njësia shpenzuese e varësisë Drejtoria e Përgjithshme Detare Durrës, me plan të shpenzimeve kapitale prej 10 milion lekë për implementimin e 4 projekteve.

4.1.8 Programi Buxhetor "Mbështetje për Energjinë"

Realizimi financiar i programit buxhetor "Mbështetje për Energjinë" sipas burimit të financimit dhe në nivel klasifikimi buxhetor rezulton të jetë:

	Plani fillestar 2024	Plani rishikuar 2024	Realizimi në lekë	Realizimi në%
Shpenzime korrente	113,156,000	113,582,870	69,821,107	61.4%
Shpenzime kapitale FB	250,000,000	250,000,000	0	0 %
Shpenzime kapitale FH	2,880,000,000	2,880,000,000	399,638,980	13,9%

Në shpenzimet korrente të programit, plani i rishikuar 2024 ka një rritje prej 426,870 lekë që vjen nga rialokimi i fondit të veçantë. Si më poshtë vijon, paraqiten të dhënat krahasuese për realizimin financiar për

të njëjten periudhë të vitit 2023. Rezulton se për 4-mujorin e parë të vitit 2024, ka një realizim më të lartë si në vlerë nominale dhe në %.

në / 000 lekë

Shpenzimet Korrente	Realizimi Financiar Viti 2023	Realizimi Financiar Viti 2024
Artikulli 600	7.656 lekë	10,833 lekë
Artikulli 601	1,258 lekë	1,706 lekë
Artikulli 602	34,308 lekë	57,282 lekë
Artikulli 605	0 lekë	0 lekë
Artikulli 606	159 lekë	0 lekë
TOTALI	43,222 LEKË	69,821 LEKË
REALIZIMI NË%	41.6%	61.4%

Shpenzimet korrente në program shërbëjnë për mirëfunksionimin e aktivitetit operacional të 3 njësjve shpenzuese të varësisë:

- ✓ Agjencia Kombëtare Bërthamore;
- ✓ Agjencia e Efiçencës së Energjisë;
- ✓ Aparati i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (shpenzime arbitrazhi);

Tavani buxhetor i shpenzimeve kapitale nuk ka pësuar ndryshime gjatë periudhës së 4- mujorit të parë 2024.

Realizimi i shpenzimeve kapitale me financim të brendshëm të programit nuk ka realizim për 4-mujorin e I të vitit 2024, sikundër dhe periudha referuese e vitit 2023.

në / 000 lekë

Shpenzimet Kapitale FB	Realizimi Financiar Viti 2023	Realizimi Financiar Viti 2024
Artikulli 231	0 lekë	0 lekë
REALIZIMI NË%	0%	0%

Shpenzimet kapitale me financim të brendshëm të programit realizohen nga 4 njësi shpenzuese të varësisë si vijon:

- ✓ Aparati i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, me plan të shpenzimeve kapitale prej 3.97 milion lekë për implementimin e 1 projekti;
- ✓ Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, me plan të shpenzimeve kapitale prej 20,5 milion lekë për implementimin e 8 projekteve;
- ✓ Agjencia e Efiçencës së Energjisë, me plan të shpenzimeve kapitale prej 225,5 milion lekë për implementimin e 34 projekteve të efiçencës së energjisë;

Realizimi i shpenzimeve kapitale me financim të huaj të programit ka një realizim më të lartë si në vlerë nominale, dhe në % krahasuar me periudhën referuese të vitit 2023.

Artikulli 231	0 lekë	399,639 lekë
REALIZIMI NË%	0%	13.9%

Shpenzimet kapitale me financim të huaj të programit realizohen nga disa njësi shpenzuese si vijon:

- ✓ Aparati i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, për implementimin e projekteve;
 - *Konvikte të rinovuara me eficence te energjise (Faza e dyte) Qyteti Studentit nr 1*
- ✓ Shoqëria KESH sha (PIU), për implementimin e 2 projekteve
 - *Rehabilitimi i Hidrocentralit të Fierzës (DKT)*
 - *Fuqia Energjitike dhe Siguria e Diges ne Kaskaden e Drinit;*
- ✓ Shoqëria OSHEE Grop sha, për implementimin e projekteve
 - *SCADA -Zgjerimi i sistemit SCADA ne godinen Qendrore te OSHEE;*
 - *Rikonstruksioni i Nënstacioneve 110kV në rajonet (Tiranë, Durrës dhe integrimi i tyre në sistemin Scada);*
 - *Ndërtimi i Nënstacionit Kamëz (Valias) me fuqi 2x40MV (ONAN/ONAF) 110/20KVA dhe ndërtimi i dy fiderave 20kV (V4, V5P);*
 - *Për Reagimin ndaj Krizës së Pandemisë Covid 19/Ndërtimi i N/Stacionit 110/20 kV, Nëntokësor, QENDER në Tiranë , Komponenti 2 (Financim GRANT);*
- ✓ Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore për implementimin e projekteve IPA;

4.1.9 Programi Buxhetor "Transporti Rrugor"

Realizimi financiar i programit buxhetor "Transporti Rrugor" sipas burimit të financimit dhe në nivel klasifikimi buxhetor rezulton të jetë:

	Plani fillestar 2024	Plani rishikuar 2024	Realizimi në lekë	Realizimi në%
Shpenzime korrente	2,992,522,000	2,993,019,800	595,405,703	19.9%
Shpenzime kapitale FB	17,602,890,000	17,602,890,000	2,823,733,683	16%
Shpenzime kapitale FH	2,488,132,000	3,488,132,000	605,384,200	17,4%

Në shpenzimet korrente të programit, plani i rishikuar 2024 ka një rritje prej 497,800 lekë që vjen nga rialokimi i fondit të veçantë. Si më poshtë vijon, paraqiten të dhënat krahasuese për realizimin financiar për të njëjtën periudhë të vitit 2023. Rezulton se për 4-mujorin e parë të vitit 2024 ka një realizim më të ulët si në vlerë nominale dhe në %.

në / 000 lekë

Shpenzimet Korrente	Realizimi Financiar Viti 2023	Realizimi Financiar Viti 2024
Artikulli 600	47,111 lekë	83,931 lekë

Artikulli 601	7,886 lekë	14,161 lekë
Artikulli 602	758,417 lekë	497,179 lekë
Artikulli 605	0 lekë	0 lekë
Artikulli 606	16 lekë	135 lekë
TOTALI	813,430 LEKË	595,406 LEKË
REALIZIMI NË%	28,7%	19,9%

Shpenzimet korrente në program shërbëjnë për mirëfunksionimin e aktivitetit operacional të njërive shpenzuese si vijon:

- ✓ Autoriteti Rrugor Shqiptar;
- ✓ Drejtoria e Rajonit Qendror Tiranë;
- ✓ Drejtoria e Rajonit Verior Shkodër;
- ✓ Drejtoria e Rajonit Jugor Gjirokastër
- ✓ Drejtoria e Rajonit Qendër Lindje Korçë
- ✓ Instituti i Transportit

Artikulli 602 përmban jo vetëm shpenzimet e administrimit për njësitë shpenzuese të sipërcituara, por edhe shpenzimet e kontratave të mirëmbajtjes së rrugëve.

ARRSH administron një rrjet rrugor prej 3606,05 km nga të cilat :

- ✓ 1400 km janë rrugë primare dhe mirëmbahen me 4 kontrata mirëmbajtje;
- ✓ 2206,05 km janë rrugë sekondare që mirëmbahen me 48 kontrata mirëmbajtje.

Buxheti për vitin 2024 për kontratat e mirëmbajtjes është në vlerën 2,375,087,000 lekë dhe realizimi për 4-mujorin I të vitit 2024 është në vlerën 459,320,842 lekë ose 19.3 % e planit.

Tavani buxhetor i shpenzimeve kapitale me financim të brendshëm nuk ka pësuar ndryshime gjatë periudhës së 4-mujorit të parë 2024. Realizimi i shpenzimeve kapitale me financim të brendshëm të programit ka një realizim më të ulët në vlerë nominale dhe në % krahasuar me periudhën referuese të vitit 2023.

Ka një pakësim të tavanit buxhetor në programin buxhetor "Transporti Rrugor", prej 988 milion lekë, krahasuar me periudhën referuese 2023. Në buxhetin 2024, projektet e reja që janë në procedurë prokurimi përbëjnë 31.5% të tavanit buxhetor për këtë program, ku krahasuar me periudhën referuese 2023, projektet e reja përbëjnë vetëm 18.3% të tavanit buxhetor të programit. Për vitin 2024 projektet e reja që janë në procedurë prokurimi përbëjnë 79% të tavanit buxhetor për ARRSH brenda programit të transportit krahasuar me periudhën referuese 2023 që përbëjnë 50%;

në / 000 lekë

Shpenzimet Kapitale FB	Realizimi Financiar Viti 2023	Realizimi Financiar Viti 2024
Artikulli 230	15,646 lekë	0 lekë
Artikulli 231	6,336,727 lekë	2,823,733 lekë
REALIZIMI NË%	34.3%	16%

Shpenzimet kapitale me financim të brendshëm të programit realizohen nga 3 njësi shpenzuese të varësisë si vijon:

- ✓ Aparati i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, me plan të shpenzimeve kapitale prej 10,26 miliard lekë për implementimin e projektit të ndërtimit të Tunelit të Llogarasë dhe projekteve koncensionare të infrastrukturës rrugore;
- ✓ Autoriteti Rrugor Shqiptar, me plan të shpenzimeve kapitale prej 7,3 miliard lekë për implementimin e projekteve infrastrukturore si vijon:

Emertimi i Projektit	Plani 2024	Realizimi 4-mujori I 2024	Realizimi në %
Rrjeti i rrugëve Nationale	7,339,429,000	130,990,282	1.8
Ndërtim rrugësh	5,773,356,000	12,000,000	0
Supervizion Punimesh	87,173,000	1,821,036	2.1
Sinjalistikë dhe siguri rrugore	186,000,000	4,000,000	2.2
Studim Projektme	50,000,000	0	0
Kosto Lokale	500,000,000	14,354,940	2.9
TVSH dhe taksë doganore	682,000,000	97,470,842	14.3
Vendime gjyqësore	5,000,000	0	0
Shpronësime	5,000,000	1,343,464	26.9
Te ndryshme	40,900,000	0	0
Fond emergjence total (ura+ emergjenc)	10,000,000	0	0

- ✓ Instituti Studimeve të Transportit Tiranë, me plan të shpenzimeve kapitale prej 3 milion lekë;

Realizimi i shpenzimeve kapitale me financim të huaj të programit ka një realizim më të ulët në vlerë nominale, dhe më lartë në % krahasuar me periudhën referuese të vitit 2023.

në / 000 lekë

Shpenzimet Kapitale FH	Realizimi Financiar Viti 2023	Realizimi Financiar Viti 2024
Artikulli 230	0 lekë	78,756 lekë
Artikulli 231	602,059 lekë	526,628 lekë
REALIZIMI NË%	12,5%	17,4%

Shpenzimet kapitale me financim të huaj të programit realizohen nga Autoriteti Rrugor Shqiptar dhe Njësitë e menaxhimit të projekteve të huaja:

- ✓ Përmirësimi dhe rehabilitimi i Urave (Financim i Bankës Botërore);
- ✓ Ndërtim segmenti rrugor Qukës – Qafë Pllocë Loti 1, Loti 2, Loti 3;
- ✓ Ndërtim By pass Tirana;
- ✓ Studim projekte për Urën e Vjosës, Beshirit, urën e grupit A dhe urën e grupit B;

4.1.10 Programi Buxhetor "Transporti Hekurudhor"

Realizimi financiar i programit buxhetor "Transporti Hekurudhor" sipas burimit të financimit dhe në nivel klasifikimi buxhetor rezulton të jetë:

	Plani fillestar 2024	Plani rishikuar 2024	Realizimi në lekë	Realizimi në%
Shpenzime korrente	524,955,000	525,055,800	160,248,471	30,5%
Shpenzime kapitale FB	550,000,000	550,000,000	148,394,471	27%
Shpenzime kapitale FH	3,202,393,000	4,202,393,000	54,700,860	3,7%

Në shpenzimet korrente të programit, plani i rishikuar 2024 ka një rritje prej 100,800 lekë që vjen nga rialokimi i fondit të veçantë. Si më poshtë vijon, paraqiten të dhënat krahasuese për realizimin financiar për të njëjtën periudhë të vitit 2023. Rezulton se për 4-mujorin e parë të vitit 2024 ruan pothuajse të njëjtin nivel të realizimit financiar si në vlerë nominale dhe në % me periudhën krahasuese të vitit 2023.

në / 000 lekë

Shpenzimet Korrente	Realizimi Financiar Viti 2023	Realizimi Financiar Viti 2024
Artikulli 600	2,865 lekë	1,723 lekë
Artikulli 601	478 lekë	274 lekë
Artikulli 602	1,221 lekë	3,6 lekë
Artikulli 603	153,479 lekë	158,248 lekë
<u>Artikulli 606</u>	<u>59 lekë</u>	<u>0 lekë</u>
TOTALI	158,102 LEKË	160,248 LEKË
REALIZIMI NË%	30,7%	30,5%

Shpenzimet korrente në program shërbëjnë për mirëfunksionimin e aktivitetit operacional të njërive shpenzuese si vijon:

- ✓ Autoriteti Sigurisë Hekurudhore;
- ✓ Hekurudha Shqiptare Sh.A e cila administron fondin buxhetor të artikullit 603 "Subvencione"

Tavani buxhetor i shpenzimeve kapitale me financim të brendshëm nuk ka pësuar ndryshime gjatë periudhës së 4- mujorit të parë 2024. Realizimi i shpenzimeve kapitale me financim të brendshëm të programit ka një realizim më të lartë në vlerë nominale dhe në % krahasuar me periudhën referuese të vitit 2023.

në / 000 lekë

Shpenzimet Kapitale FB	Realizimi Financiar Viti 2023	Realizimi Financiar Viti 2024
Artikulli 230	0 lekë	20,268 lekë
Artikulli 231	129,428 lekë	128,126 lekë
REALIZIMI NË%	23,5%	27%

Shpenzimet kapitale me financim të brendshëm të programit realizohen nga shoqëria Hekurudha Shqiptare sha

- ✓ 3 projekte për studim projektim të buxhetuara në vlerën 71,3 milion lekë;
- ✓ 10 projekte për mirëmbajtje të ndryshme dhe rinovime të trungut hekurudhor të buxhetuara në vlerën 228,5 milion lekë;
- ✓ TVSH dhe Kosto lokale për projektet me financim të huaj të programit të buxhetuara në vlerën 250,2 milion lekë;

Realizimi i shpenzimeve kapitale me financim të huaj të programit ka një realizim më të ulët në vlerë nominale, dhe më lartë në % krahasuar me periudhën referuese të vitit 2023. Tavanin e rishikuar buxhetor i shpenzimeve kapitale me financim të huaj për vitin 2024 është rritur me 824 milion lekë, krahasuar me tavanin buxhetor të programit për vitin 2023.

në / 000 lekë

Shpenzimet Kapitale FH	Realizimi Financiar Viti 2023	Realizimi Financiar Viti 2024
Artikulli 230	0 lekë	1,8 lekë
Artikulli 231	868,870 lekë	154,699 lekë
REALIZIMI NË%	25,7%	3,7%

Shpenzimet kapitale me financim të huaj të programit realizohen nga shoqëria "Hekurudha Shqiptare", sha

4.1.11 Programi Buxhetor "Furnizimi me Ujë dhe Kanalizime"

Realizimi financiar i programit buxhetor "Furnizimi me ujë dhe Kanalizime" sipas burimit të financimit dhe në nivel klasifikimi buxhetor rezulton të jetë:

	Plani fillestar 2024	Plani rishikuar 2024	Realizimi në lekë	Realizimi në%
Shpenzime korrente	485,751,000	615,851,800	29,114,745	4,7%
Shpenzime kapitale FB	8,813,602,000	8,813,602,000	2,084,909,375	23,7%
Shpenzime kapitale FH	2,207,004,000	3,243,539,000	77,053,380	2,4%

Në shpenzimet korrente të programit, plani i rishikuar 2024 ka një rritje prej 130,100,800 lekë që vjen nga:

- ✓ rialokimi i fondit të veçantë në vlerën 100,800 lekë;
- ✓ artikulli 600 shtuar me 90,000,000 lekë;
- ✓ artikulli 601 shtuar me 10,000,000 lekë;
- ✓ artikulli 602 shtuar me 30,000,000 lekë;

Shtesat në artikujt buxhetore 600+601+602, vlerën totale prej 130,000,000 lekë janë në zbatim të Aktit Normativ nr1, datë 21.02.2024 "Për disa ndryshime në ligjin 97/2023 "Për buxhetin e vitit 2024" dhe lidhen me mirëfunksionimin e aktivitetit operacional të strukturës së Task Forcës.

Si më poshtë vijon, paraqiten të dhënat krahasuese për realizimin financiar për të njëjtën periudhë të vitit 2023. Rezulton se për 4-mujorin e parë të vitit 2024 ka një realizim më të lartë në vlerë nominale, por realizim më të ulët në përqindje për shkak të rritjes së planit të buxhetit të shpenzimeve korrente 2024 për sa trajtuar më lartë krahasuar me periudhën referuese të vitit 2023.

Shpenzimet Korrente	Realizimi Financiar	<i>në / 000 lekë</i> Realizimi Financiar
	Viti 2023	Viti 2024
Artikulli 600	16,325 lekë	22,235 lekë
Artikulli 601	2,727 lekë	3,574 lekë
Artikulli 602	2,523 lekë	3,306 lekë
Artikulli 603	0 lekë	0 lekë
Artikulli 606	4 lekë	0 lekë
TOTALI	21,579 LEKË	29,115 LEKË
REALIZIMI NË%	5,1%	4,7%

Shpenzimet korrente në program shërbëjnë për mirëfunksionimin e aktivitetit operacional të Agjencisë Kombëtare të Ujësjellës Kanalizimeve dhe strukturës Task Focë të ngritur brenda kësaj njësie shpenzuese. AKUK administron dhe shpenzimet e artikullit 603 "Subvencion". Këto shpenzime përdoren në zbatim të udhëzimit respektiv të Ministrit të Infrastruktës dhe Energjisë në kuadër të rritjes së performancës financiare të shoqërive ujësjellës kanalizimeve të krijuara në kuadër të reformës së ujit.

Tavani buxhetor i shpenzimeve kapitale me financim të brendshëm nuk ka pësuar ndryshime gjatë periudhës së 4- mujorit të parë 2024. Realizimi i shpenzimeve kapitale me financim të brendshëm të programit ka një realizim më të ulët si në vlerë nominale, edhe në % krahasuar me periudhën referuese të vitit 2023.

Tavani buxhetor i programit në vitin 2024 ka një rritje prej 2,3 miliard lekë krahasuar me periudhën referuese të vitit 2023. Në buxhetin 2024, projektet e reja që janë në procedurë prokurimi përbëjnë 25% të tavanit buxhetor për këtë program ku krahasuar me periudhën referuese 2023, projektet e reja përbënin vetëm 11% të tavanit buxhetor të programit.

Shpenzimet Kapitale FB	Realizimi Financiar	<i>në / 000 lekë</i> Realizimi Financiar
	Viti 2023	Viti 2024
Artikulli 230	90,300 lekë	17,767 lekë
Artikulli 231	3,287,403 lekë	2,067,142 lekë
REALIZIMI NË%	51,9%	23,7%

Shpenzimet kapitale me financim të brendshëm të programit realizohen nga Agjensia Kombëtare e Ujësjellës Kanalizimeve dhe shoqëritë e ujësjellës kanalizimeve të krijuara nga Reforma e Ujit me nënëzërat si vijon:

- ✓ Ndërtim rrjet ujësjellësi dhe rikonstrukcion rrjeti;
 - *Sasia Faktike (Viti paraardhës) në ml është 450.930 ml*
 - *Shpenzimet Faktike (sipas vitit paraardhës) janë 6.929.989 lekë*
 - *Sasia (sipas planit Fillestar Vjetor) 358.351 ml*
 - *Shpenzimet (sipas planit Fillestar Vjetor) janë 5.263.582.931 lekë*
 - *Sasia (sipas /planit të rishikuar të vitit korent) 358.351 ml*
 - *Shpenzimet (sipas /planit të rishikuar të vitit korent) 5.263.582.931 lekë*
 - *Sasia (sipas /periudhës raportuese të vitit korent) 103.480 ml*
 - *Shpenzimet (sipas / periudhës raportuese të vitit korent) 1.396.215.872 lekë*

- ✓ Studim projektim për rrjet ujësjellës;
 - *Shpenzimet Faktike (sipas vitit paraardhës) janë 15.355.600 lekë*
 - *Shpenzimet (sipas planit Fillestar Vjetor) janë 350.021.190 lekë*
 - *Shpenzimet (sipas /planit të rishikuar të vitit korent) 350.021.190 lekë*
 - *Shpenzimet (sipas / periudhës raportuese të vitit korent) 0 lekë*

- ✓ Ndërtim rrjet kanalizimi dhe ITUN dhe rikonstrukcion rrjeti;
 - *Sasia Faktike (Viti paraardhës) në ml është 31591km*
 - *Shpenzimet Faktike (sipas vitit paraardhës) janë 2.753.703 lekë*
 - *Sasia (sipas planit Fillestar Vjetor) 156.113 ml*
 - *Shpenzimet (sipas planit Fillestar Vjetor) janë 2.032.099.351 lekë*
 - *Sasia (sipas /periudhës raportuese të vitit korent) 4181 ml*
 - *Shpenzimet (sipas / periudhës raportuese të vitit korent) 533.953.574 lekë*

- ✓ Studim projektim rrjet kanalizimi dhe ITUN;
 - *Shpenzimet Faktike (sipas vitit paraardhës) janë 21.372.784 lekë*
 - *Shpenzimet (sipas planit Fillestar Vjetor) janë 323.739.307 lekë*
 - *Shpenzimet (sipas /nplanit të rishikuar të vitit korent) 313.739.307 lekë*
 - *Shpenzimet (sipas / periudhës raportuese të vitit korent) 4.457.801 lekë*

Realizimi i shpenzimeve kapitale me financim të huaj të programit ka një realizim më të lartë si në vlerë nominale, dhe në % krahasuar me periudhën referuese të vitit 2023. Tavanin e rishikuar buxhetor të shpenzimeve kapitale me financim të huaj për vitin 2024 është pakësuar me 4,18 miliard lekë krahasuar me tavanin buxhetor të programit për vitin 2023.

në / 000 lekë

Shpenzimet Kapitale FH	Realizimi Financiar Viti 2023	Realizimi Financiar Viti 2024
Artikulli 230	11,687 lekë	77,053 lekë
Artikulli 231	57,084 lekë	0 lekë
REALIZIMI NË%	0,9%	2,4%

Shpenzimet kapitale me financim të huaj të programit realizohen nga Agjencia Kombëtare e Ujësjiellës Kanalizimeve dhe njësitë e menaxhimit të projekteve në AKUK, si vijon :

- ✓ Infrastruktura Bashkiake, III, IV, V (Kredi dhe Grant);
- ✓ Programi Kombëtar i Modernizimit të Sektorit të Ujësjiellës Kanalizimeve
- ✓ Projekti i rikonstruksionit të rrjetit të brendshëm për ujësjiellësin e Bashkisë Durrës (Kredi dhe Grant)
- ✓ Projekti i kanalizimeve Tirana e Madhe;
- ✓ Furnizimi i qëndrueshëm me ujë nëpërmjet energjisë së pastër;
- ✓ Planifikimi i sektorit të ujit për negociata me BE;

4.2 PERFORMANCA JO FINANCIARE E PROGRAMIT BUXHETOR

4.2.1 Programi Buxhetor "Planifikim menaxhim Administrim"

Programi "Planifikim, Menaxhim, Administrim" ka si objektiv funksionimin dhe forcimin e kapaciteteve administrative, përmirësimin e strukturës funksionale për një menaxhim sa më efektiv të burimeve njerëzore, krijimin e një stafi permanent dhe sa më të qëndrueshëm, aplikimin e proceseve transparente të konkurimit në përputhje me parimet e barazisë gjinore, motivimin për ngritjen në detyrë sipas rezultateve, me qëllim rritjen e standardeve dhe performancës së punës.

Qëllimi i programit është mirëmenaxhimi i stafit të aparatit të MIE-së dhe politikbërja me sukses brenda fushës së përgjegjësisë shtetërore të institucionit duke respektuar parimin e barazisë gjinore dhe mosdiskriminimin.

Treguesit e performancës në këtë program janë :

- | | |
|---|-----|
| ✓ Forcimi kapaciteteve administrative nëpërmjet trajnimeve të ndryshme për punonjësit e | |
| ✓ Administrates | 50% |
| ✓ Rritja e standardeve në punë | 60% |
| ✓ Gra të përfaqësuara në nivele të larta drejtuese të Aparatit të MIE | 4 |
| ✓ Raporti gra ndaj totalit të punonjësve të Aparatit të MIE | 132 |
| ✓ Raporti burra ndaj totalit të punonjësve të Aparatit të MIE | 67 |

4.2.2 Programi Buxhetor "Planifikimi Urban"

Ky program harton, mbështet dhe zbaton procese dhe politika për planifikimin. Ka për qëllim ndër të tjera të sigurojë zhvillimin e qëndrueshëm të territorit; të vlerësojë potencialin aktual e perspektiv për zhvillimin e territorit në nivel kombëtar, rajonal e vendor; të mundësojë të drejtën e përdorimit e të zhvillimit të pronës; të krijojë kushte të përshtatshme e të drejta dhe shanse të barabarta, të sigurojë që autoritetet kombëtare e vendore të planifikimit të hartojnë e të përditësojnë rregullisht dokumentet e planifikimit.

Pjesë e aktiviteteve të këtij programi janë dy institucione varësie:

1. Arkivi Qëndror Teknik i Ndërtimit (AQTN), që mbledh, përpunon, administron, ruan dhe shërben pasurinë arkivore, e cila mbrohet dhe sigurohet nga shteti. Kjo pasuri është dokumentacion teknik me

2. vlera shkencore, teorike e praktike, në fushën e ndërtimit, me interes historik kombëtar dhe është pjesë e Fondit Arkivor Kombëtar Shqiptar (F A K SH).
3. Agjencia Shtetërore për Shpronësimin (ASHSH), funksioni i së cilës është të garantojë që procedurat e shpronësimit ose të marrjes në përdorim të përkohshëm, për interes publik, të pasurive të personave fizikë ose juridikë privatë në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë të realizohen në përputhje me kushtet dhe procedurat e përcaktuara me legjislacionin në fuqi, duke garantuar transparencën, barazinë e shtetasve dhe mbrojtjen e interesave dhe të drejtave të tyre pasurore.

Politikat e këtij programi synojnë:

- Planifikim dhe zhvillim të qëndrueshëm të territorit në çdo nivel dhe në bashkërendim me çdo sektor;
- Rigjenerimin urban dhe krijimin e modeleve të reja të zhvillimit të territorit;
- Mundëson kushte të përshtatshme për stafin i cili merret me çështjet e planifikimit dhe zhvillimit të territorit;
- Përmirëson kuadrin ligjor në fushën e projektimit;

Qëllimi i politikës së këtij programi është:

- Zhvillimi i qëndrueshëm dhe i balancuar i territorit, garantimin e ekuilibrit midis interesave publikë dhe privatë, në zhvillimin e territorit;
- Kryerja e procesit mbi rikualifikimin urban të zonave përmes projektsh pilot, urbanizimi dhe integrimi;
- Hartimin e rregullave dhe standarteve të projektimit në fushat e projektimit të universiteteve dhe ambjentet ndihmëse të tyre;
- Dixhitalizimin e dokumentave që lidhen me planifikimin dhe zhvillimin e territorit
- Ruajtjen e te drejtës së pronësisë për çdo individ

4.2.3 Programi Buxhetor "Mbështetje për Rrjetet e Komunikacionit"

Programi Buxhetor "Mbështetje për Rrjetet e Komunikacionit", është një nga programet prioritare të fushës së përgjegjësisë së MIE. Objektivat e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë përfshijnë dhe politikat e përgjithshme shtetërore në sektorin e telekomunikacionit dhe të shërbimit postar, për hartimin dhe zbatimin e politikës së përgjithshme shtetërore, në sektorin e planifikimit dhe zhvillimit urban, në sektorin e

infrastrukturës dhe transportit, në sektorin e telekomunikacionit dhe të shërbimit postar, në sektorin e energjisë, shfrytëzimit të burimeve energjetike e minerare dhe në sektorin e industrisë;

Për mbështetjen e zbatimit të politikave të zhvillimit të telekomunikacionit është miratuar programi "Mbështetje për Rrjetet e Komunikacionit", si pjesë integrale e programit buxhetor të MIE. Gjatë periudhës së raportimit Janar-Prill 2024, vëmendja kryesore e MIE në lidhje me programin mbështetje për rrjetet e komunikimit, ka qenë miratimi i ligjit të ri për komunikimet elektronike, identifikimi i masave/reformave prioritare që janë pjesë e planit të ri të rritjes në lidhje me infrastrukturën digjitale dhe rrjetet 5G. Në fokusin e punës së MIE gjatë periudhës së raportimit ka qenë zbatimi i planit kombëtar të broadband, ndjekja e angazhimeve të integritimit evropian dhe promovimi i pjesëmarrjes në Programin Digjital të BE-së.

Investime në fibër optike në zonat e bardha, bazuar në gjetjet dhe rekomandimet e projektit "Studim Fizibiliteti për zhvillimin e infrastrukturës rajonale të Broadband-it" (WB19-ALB-DII-01), si dhe në

përmbushje të objektivave të vendosura në Planin Kombëtar për Zhvillimin e Qëndrueshëm të Infrastrukturës Digjitale, Broadband 2020-2025, miratuar me VKM nr. 434 datë 3.6.2020, nevoja për investime në fibër optike në zonat e bardha është e lartë.

Investimi pritet të bëhet pas përfundimit të asistencës teknike WB24-ALB-DII-01 që do të përfitësojë studimin e fizibilitetit, CBA dhe përgatisë tender document. Asistenca teknike e EBIF për rishikimin e studimit të fizibilitetit, CBA dhe përgatitjen e dokumentave të tenderit ka filluar në Dhjetor 2023. Gjatë periudhës së raportimit Janar–Prill 2024, nga asistenca teknike është dorëzuar raporti fillestar (në Shkurt 2024), raporti rregullator dhe është punuar për rishikimin e analizës së infrastrukturës ekzistuese të broadband.

Zbatimi i Marrëveshjes Shqipëri-Kosovë mbi Autostradën Digjitale 5G Prishtinë-Tiranë, është i lidhur me zhvillimet e rrjeteve të së ardhmes dhe zbatimit të aplikacioneve digjitale, inovacionin për industrinë vertikale (energji, transport), qytetet e zgjuara (smart cities) dhe zhvillimet inovatore në ekonomi dhe shoqëri. Infrastruktura digjitale e shpejtësisë së lartë dhe shumë të lartë nënkupton rrjete me fibër optike dhe 5G. Aktualisht rrjetet 5G nuk janë prezent në Shqipëri. Nevoja për investime për zhvillimin e tyre është e lartë. Në fazën e parë del nevoja e kryerjes së një studimi për implementimi e Marrëveshjes Shqipëri-Kosovë mbi Autostradën Digjitale 5G Prishtinë-Tiranë;

Zbatimi i kuadrit të ri ligjor për komunikimet elektronike përmes draftimit të akteve nënligjore në zbatim të tij lidhet me miratimin e ligjit të ri të komunikimeve elektronike. Projektligji i ri “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i bazuar në Direktivën BE 2018/1972, është miratuar nga Këshilli i Ministrave me VKM nr.99 datë 06.03.2024, dhe ka kaluar për miratim në Kuvend. Aktualisht projektligji është në proces shqyrtimi në komisionet parlamentare dhe pritet të miratohet në seancë plenare brenda muajit maj 2024. Për implementimin e këtij ligji lind nevoja e draftimit të akteve nën ligjore që rrjedhin prej tij, të parashikuara në programin buxhetor të vitit 2024. Gjithashtu për implementimin e ligjit të ri lind nevoja e planit të komunikimi si dhe promovimit të zbatimit të ligjit të ri për komunikimet elektronike.

WiFi4AL - Sigurimi i mbulimit me E-Fi falas për qytetarët dhe vizitorët në hapësirat publike si parqe, sheshe, ndërtesa publike, biblioteka, qendra shëndetësore dhe muze në Shqipëri përmes projektit WiFi4AL – në zbatim të Planit Kombëtar të Broadbandit si dhe angazhimit të marrë nga udhëheqësit e vendeve të Ballkanit Perëndimor në Samitin e procesit të Berlinit të zhvilluar në 6 Tetor 2023 në Tiranë. Objektivi i këtij projekti është ofrimi i Wi-Fi falas për qytetarët dhe vizitorët në hapësirat publike si parqe, sheshe, ndërtesa publike, biblioteka, qendra shëndetësore dhe muze në Shqipëri.

Programin Digjital i BE-së është miratuar nga Bashkimi Evropian me Rregulloren (EU) 2021/694, për të mbështetur transformimin digjital në periudhën 2021-2027 i cili përmban pesë objektiva specifike:

- Objektivi 1: Përpunimi kompjuterik me performancë të lartë;
- Objektivi 2: Inteligjenca artificiale, të dhënat dhe cloud;
- Objektivi 3: Siguria kibernetike dhe besimi;
- Objektivi 4: Aftësitë digjitale të avancuara;
- Objektivi 5: Përsheptimi i përdorimit sa më të mirë të teknologjive digjitale.

Transformimi digjital ka një prekje të gjerë si nga sektori publik, ekonomia, academia, industria, etj. Ky proces ka nevojë për rritjen e kapaciteteve teknike, zhvillimin e projekteve, infrastrukturës digjitale, zgjidhje/platforma inovatore digjitale, aftësive digjitale, etj.

Në këtë kuadër parashikohet të përgatitet një plan komunikimi si dhe promovimi për pjesëmarrjen e entiteteve ligjore në Shqipëri në projektet e BE-së në kuadër të DEP dhe EDIH; Gjatë këtij 4 muajori ka filluar procesi i hartimit të planit të komunikimit.

4.2.4 Programi Buxhetor "Transporti Ajror"

Programi buxhetor "Transporti Ajror", merret me hartimin e politikave zhvilluese të transportit ajror që synojnë përmirësimin e kuadrit ligjor dhe administrativ, në përputhje të plotë me standardet ndërkombëtare dhe për të mundësuar gjetjen e burime të ndryshme financuese dhe investuese për infrastrukturën aeroportuale, me qëllim krijimin e një tregu konkurrues në shërbimet ajrore.

Autoriteti Kombëtar i Investigimit për Sigurinë e Operimit në Aviacionin Civil është themeluar në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 100, pika 2, e 101, të ligjit 96/2020, "Kodi Ajror i Republikës së Shqipërisë. Autoriteti i Investigimit ka si mision përmirësimin e sigurisë ajrore dhe parandalimin e aksidenteve dhe incidenteve, nëpërmjet investigimit të tyre dhe nxjerrjes së shkaqeve, në zbatim të legjislacionit në fuqi. Investigimi i aksidenteve dhe i incidenteve të rënda kryhet nga AKISA (safety) në Aviacionin Civil, në varësi të Ministrisë përgjegjëse për transportin.

Qëllimet e Politikës së Programit: Integrimi i aviacionit civil shqiptar në sistemet evropiane të transportit ajror në nivel administrativ dhe nivel tekniko-funksional.

Objektivat dhe produktet të cilat synohen të arrihen gjatë kësaj periudhe, përgjithësisht janë të lidhur me:

- zhvillimin dhe ndërtimin e infrastrukturave të reja aeroportuale, me qëllim krijimin e një tregu konkurrues me shërbime ajrore të liberalizuara;
- rritjen e standardeve dhe performancës së Autoritetit Kombëtar të Investigimit për Sigurinë e Operimit në Aviacionin Civil nëpërmjet investimeve për forcimin e kapaciteteve,

4.2.5 Programi Buxhetor "Mbështetje për Industrinë"

Programi "Mbështetje për Industrinë" ka për qëllim rritjen e nivelit të sigurisë së shfrytëzimit, mirëmbajtjes dhe përdorimit të produkteve, pajisjeve, instalimeve industriale, instalimeve elektrike dhe pajisjeve nën presion, eliminimin e rrezikut të dëmtimit të shëndetit të njerëzve dhe mjedisit nga kimikatet e rrezikshme të papërdorshme gjendje në kushte të pa sigurta depozitimi dhe ruajtje në magazinat apo ambientet e ish ndërmarrjeve dhe ndërmarrjeve publike në varësi të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë.

Pjesë e aktiviteteve të këtij programi janë:

1. Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial, i cili ushtron një veprimtari të gjerë, të shtrirë në të gjithë territorin e vendit për inspektimin, zbatimin dhe përmbushjen e kërkesave ligjore e nënligjore në fushën e përpunimit, transportimit dhe tregtimit të naftës, gazit e nënprodukteve të tyre, si dhe të sigurimit të punës për instalimet, pajisjet nën presion, për pajisjet dhe instalimet elektrike dhe të sistemeve të gazifikimit dhe impianteve kombëtare.

2. Qendra e Grumbullimit dhe Trajtimit të Kimikateve të Rrezikshme ka për mision reduktimin e rrezikut të ndotjes të mjedisit dhe dëmtimit të shëndetit të njerëzve nga keqpërdorimi apo trafikimi për përfitime të paligjshme të kimikateve të rrezikshme, të mbetura në kushte të pasigurta depozitimi dhe ruajtjeje në magazinat apo ambientet e ish-ndërmarrjeve dhe subjekteve publike të fushës së veprimtarisë së Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë.

Politikat e këtij programi synojnë:

- Nxitjen e interesit për investime të biznesit vendas dhe të huaj në zhvillimin e veprimtarisë industriale;
- Rritjen e nivelit të sigurisë së shfrytëzimit, mirëmbajtjes dhe përdorimit të produkteve, pajisjeve, instalimeve industriale, instalimeve elektrike dhe pajisjeve nën presion.
- Eliminimin e rrezikut të dëmtimit të shëndetit të njerëzve dhe mjedisit nga kimikatet e rrezikshme të papërdorshme gjendje në kushte të pa sigurta depozitimi dhe ruajtjeje në magazinat apo ambientet e ish ndërmarrjeve dhe ndërmarrjeve publike

Qëllimi i politikës së këtij programi është:

- Sigurimi i kushteve për monitorimin e standarteve teknike në fushën e hidrokarbureve, minierave dhe industrisë, për problemet e sigurisë së produkteve/pajisjeve/instalimeve dhe në tërësi veprimtarisë industriale në fushën e nxjerrjes dhe përpunimit si dhe në punimet nëntokësore të veprave hidroenergjetike.
- Krijimi i kushteve për miradministrimin e kimikateve të trashëguara dhe dy landfilleve në të cilat janë depozituar mbetjet e rrezikshme si dhe konservimi dhe mbyllja e ish ndërmarrjeve industriale në varësi të MIE-s.
- Eliminimi i rrezikut të dëmtimit të shëndetit të njerëzve dhe mjedisit nga kimikatet e rrezikshme të papërdorshme, në gjendje e në kushte të pa sigurta depozitimi.

4.2.6 Programi Buxhetor "Mbështetje për Burimet Natyrore"

Ky program harton, mbështet dhe zbaton proceset dhe politikat për burimet natyrore. Programi ka për qëllim identifikimin e mundësive për një zhvillim të qëndrueshëm në sektorin minerar, nëpërmjet realizimit të politikave të promovimit, mbikqyrjes, monitorimeve si dhe transparencës.

Pjesë e aktiviteteve të këtij programi janë edhe dy institucione varesie:

1. Shërbimi Gjeologjik Shqiptar i cili ka si objektiv evidentimin e resurseve të burimeve natyrore minerare, hidrokarbure dhe hidrologjike me qëllim nxitjen e shfrytëzimit maksimal, zhvillimin e mëtejshëm të sistemit të informacionit, bankës së të dhënave për të mundësuar transmetimin në kohë të informacionit drejt vendim-marrësve, si dhe parandalimin e rreziqeve gjeologo-mjedisore, hidrologjike, nëpërmjet kryerjes së studimeve dhe analizave paraprake në mbështetje të pushtetit qëndror dhe lokal.
2. Autoriteti Kombëtar për Sigurinë dhe Emergjencat në Miniera (AKSEM), i cili kryen veprimtari inspektimi në fushën e sigurisë në punë, të emergjencave dhe të shpëtimit në veprimtarinë minerare dhe punimet nëntokësore të veprave hidroenergjetike.

Politikat e këtij programi synojnë:

-

- Promovimin e burimeve të pashfrytëzuara të mineraleve të kromit, bakrit dhe ranor silicor, vlerësimi sasior dhe cilësor i rezervave minerare, hartimi i studimeve dhe projekteve gjeologjike, studimi dhe vlerësimi i pasurive natyrore të lëndëve hidroenergjetike. Vlerësimin e rreziqeve gjeologjike mbi qëndrueshmërinë e truallit dhe infrastrukturës publike në shkallë vendi dhe vlerësime emergjente. Mirëadministrimi i territorit në shkallë vendi, nëpërmjet përpilimit të hartave gjeologjike, gjeomjedisore gjeomonumenteve.
- Shfrytëzimin me efikasitet të burimeve natyrore minerare nga shoqëritë e licensuara për këtë veprimtari nëpërmjet zbatimit të kushteve tekniko - profesionale dhe mjedisore sipas standarteve europiane.
- Rritjen e transparencës në industrinë nxjerrëse, me qëllim rritjen e cilësisë në mirëqeverisjen e industrisë nxjerrëse.

Qëllimi i politikës së këtij programi është:

- Promovimin e burimeve të pashfrytëzuara.
- Përmirësimi i standarteve në kuadër të sigurisë në miniera dhe ndërhyrjeve shpëtuese.
- Shfrytëzimi me efikasitet të burimeve natyrore minerare nga shoqëritë e licensuara për këtë veprimtari.
- Rritja e transparencës në industrinë nxjerrëse.

4.2.7 Programi Buxhetor "Transporti Detar"

Programi buxhetor "Transporti Detar", ka për qëllim zhvillimin e Shqipërisë nga një vend bregdetar, në një vend të zhvilluar detar orientuar drejt rritjes ekonomike e integritimit evropian, nëpërmjet përmirësimit të infrastrukturës, kapaciteteve njerëzore, sigurisë dhe sistemit të menaxhimit në porte.

Objektivi i këtij programi është kryerja e investimeve prioritare për funksionimin me kapacitet të plotë të porteve dhe përmirësimin e infrastrukturës portuale duke sjellë një rritje të investimeve do të shërbejë në zhvillimin e Shqipërisë, nëpërmjet përmirësimit të infrastrukturës, kapaciteteve njerëzore, sigurisë dhe sistemit të menaxhimit në porte.

4.2.8 Programi Buxhetor "Mbështetje për Energjinë"

Qëllimi i politikës së programit, ka për qëllim të nxisë rritjen e sektorit energjetik përmes mbështetjes buxhetore, për një zhvillim të qëndrueshëm të ekonomisë, nëpërmjet garantimit dhe furnizimit me burime të sigurta energjetike me kosto minimale. Programi mbështetet me fonde buxhetore të nevojshme, për zbatimin e politikave në fushën e energjisë, elektroenergjetike, energjisë së rinovueshme, efikasitetit të energjisë, hidrokarbureve.

Programi buxhetor "Mbështetje për Energjinë", konsiston në :

- Zhvillimin e mëtejshëm të burimeve të qëndrueshme të energjisë, përdorimit efikasitet të tyre, rritjen ekonomike të shoqëruar me sisteme të integruara rajonale dhe kombëtare të energjisë;

- Diversifikimin e burimeve të energjisë, bazuar në parimet e tregut dhe në përputhje me kërkesën për energji, për zhvillim të qëndrueshëm të ekonomisë, duke garantuar sigurinë dhe cilësinë e furnizimit, mbrojtjen e mjedisit dhe veprimet klimatike, rritjen e mirëqenies me kosto sociale minimale.
- Implementimi i politikave dhe strategjive në zbatim të programit dhe prioriteteve të Qeverisë, si dhe përmbushjen e angazhimeve, në kuadrin e Traktatit të Komunitetit të Energjisë e Direktivave të BE.
- Mbështetje e politikave, në kuadrin ligjor, nënligjor dhe institucional në sektorin energjetik dhe mbështetjen e mëtejshme, për krijimin e kushteve për nxitjen dhe hapjen e tregut energjetik në përputhje me paketën e tretë rregullatore të BE.

4.2.9 Programi Buxhetor "Transporti Rrugor"

Bazuar në objektivin e përgjithshëm të Strategjisë Sektoriale të Transportit dhe Planit të Veprimit, programi buxhetor mbështet :

- Zhvillimin e mëtejshëm të sistemit kombëtar të transportit;
- Përfundimi i akseve të Koridorit VIII dhe të Koridorit Blu, projekte të cilat kanë filluar të ndërtohen dhe janë në listën e Projekteve Strategjike Kombëtare
- Përmirësimin e qëndrueshmërisë, ndërlidhjen, ndërveprimin dhe integrimin e infrastrukturës rrugore me sistemin ndërkombëtar dhe evropian të transportit dhe rajonin;
- Financimin për projektet që sigurojnë zgjerimin, rritjen e standardeve dhe mirëmbajtjen e rrjetit kombëtar të rrugëve, me synim krijimin e një transporti të qëndrueshëm;

Qëllimi i Politikës së programit është:

- Të krijohen parakushtet për zhvillimin e sektorëve të tjerë të ekonomisë;
- Të rritet aksesimi i mallrave dhe udhëtarëve në tregti dhe ofrimin e shërbimeve;
- Të kontribuohet në mënyrë të konsiderueshme në rritjen e përgjithshme dhe zhvillimin e ekonomisë;
- Rehabilitimi dhe mirëmbajtja e rrjetit të rrugëve nacionale, për të ruajtur investimet e realizuara në infrastrukturën rrugore.

4.2.10 Programi Buxhetor "Transporti Hekurudhor"

Qëllimi i politikës së programit, është integrimi i sistemit hekurudhor shqiptar me atë rajonal dhe evropian në nivel administrativ dhe nivel tekniko-funksional.

Objektiva të programit janë:

- Ruajtja e mjedisit të gjelbër dhe ndërlidhës, në përputhje me objektivat strategjik për zhvillim dhe integrim të Shqipërisë, në sektorin e transportin;
- Transformimi i nivelit teknik në sistemin hekurudhor, duke garantuar sigurinë në lëvizje dhe rritje të performancës në lëvizje të trenave;
- Përmirësimin e infrastrukturës hekurudhore dhe disponibilitetin e mjeteve hekurudhore;
- Ulja e numrit të aksidenteve;
- Rritja e shpejtësisë mesatare të lëvizjes së trenave kundrejt 30 km/orë;

Prioriteti kryesor në fushën e transportit hekurudhor ka qenë dhe mbetet "Reformimi i sektorit hekurudhor

për të krijuar një treg të hapur për publikun dhe investitorët privatë"

4.2.11 Programi Buxhetor "Furnizimi me Ujë dhe Kanalizime"

Qëllimi i politikës së programit, është reformimi i sektorit të Ujësjetës-Kanalizimeve, i cili është prioritet i Qeverisë Shqiptare, në përmbushje të vizionit të Strategjisë Kombëtare për një sistem të besueshëm mbarëkombëtar për furnizimin me ujë dhe kanalizime që plotëson nevojat e një ekonomie në zhvillim, bazuar në :

- Furnizim me ujë të zonave urbane;
- Zgjerimin dhe përmirësimin e furnizimit me ujë të zonave bregdetare;
- Furnizimin me ujë të zonave rurale;
- Mbulimin e kostos operative dhe rritja e performancës së Shoqërive të reja Rajonale;
- Mbulimin me Kanalizime dhe ITUN

Disa prej kompetencave që ushtron AKUK janë si në vijim:

a) Përgatit planifikimin e nevojave për investime për ndërtimin / rehabilitimin / zgjerimin e sistemeve të ujësjetës-kanalizimeve, të impianteve të trajtimit të ujërave të ndotura (ITUN), bazuar në programet e qeverisë dhe në masterplanet kombëtare sektoriale.

b) Orienton nga pikëpamja teknike e menaxheriale dhe bashkëpunon për të gjitha projektet e ujësjetës-kanalizimeve, të ITUN-eve, të financuara nga buxheti i shtetit, buxheti i bashkisë, buxheti i shoqërisë "Ujësjetës-Kanalizime" sh.a., apo institucione financiare ndërkombëtare.

c) Koordinon nismat për investime në fushën e ujësjetës-kanalizimeve, në bazë të rëndësisë strategjike, si dhe merr pjesë e ofron këshillime gjatë procesit të hartimit të projekteve në fushën e ujësjetës-kanalizimeve. Përgatit, gjithashtu, projekte zhvillimore dhe projekte pilot, me kërkesë të bashkive, qarqeve dhe ministrive apo institucioneve të tjera të administratës publike.

d) Është institucioni përgjegjës për hartimin dhe zbatimin e procedurave e të programit të monitorimit për shërbimet e furnizimit me ujë.

4.3 VEPRIMET VIJUESE NË NIVELIN E PROGRAMIT BUXHETOR

Veprimet vijuese lidhen me realizimin e buxhetit të vitit 2024 në nivelet maksimale. Për 4 mujorin e parë të vitit 2024, sikurse është shpjeguar dhe më lartë në nivel programi, projektet e reja, janë në procedurë prokurimi dhe prandaj realizimi i 4 mujorit të parë nuk paraqitet në nivelin e periudhës krahasuese 2023.

5. PROJEKTET KAPITALE

Projektet kapitale priotitare të cilat po implementohen nga MIE, sipas programeve buxhetore, me financim nga buxheti i shtetit dhe me financim të huaj, përmendim:

Tavani buxhetor i programi buxhetor "Transporti Rrugor", përbën 37% të totalit të buxhetit të rishikuar të MIE për shpenzimet kapitale.

Tavani buxhetor i programit për shpenzimet kapitale me financim të brendshëm përbën 47% të buxhetit të rishikuar 2024 për shpenzimet kapitale me financim të brendshëm. Projektet prioritare me financim të brendshëm janë:

- Zbatimi dhe financimi i projekteve koncesionare të infrastrukturës rrugore të MIE:
 - Ndërtim, operim, mirëmbajtje Rruga e Arbrit;
 - Ndërtim, operim, mirëmbajtje Rruga Orikum-Dukat- Porti I Jahteve;
 - Ndërtim Tuneli i Llogarasë.

- Zbatimi dhe financimi i projekteve të infrastrukturës rrugore nga Autoriteti Rrugor Shqiptar ndahen në:

- ✓ Ndërtim rruge tip A me katër korsi (2x2), sipas standarteve të reja, ku janë përfshirë kryesisht tip rruge me katër korsi dhe gjërësi që varion nga 24-25 m, përmendim :
 - Rehabilitim i segmentit rrugor mbikalimi pallati me shigjeta rrethrotullimi Shqiponja;
 - Plotësimi, rakordimi dhe vazhdimi i punimeve për rehabilitimin e segmentit rrugore mbikalimi pallati me shigjeta rrethrotullimi Shqiponja Loti 3;
 - Ndërtim rruga mbikalimi Teg dhe rrugët lidhëse të tij;
 - Ndërtim i Unazës së Jashtme Tiranë;
 - Plotësimi, rakordimi dhe vazhdimi i punimeve Sheshi Shqiponja - Lumi i Tiranës, Loti 1 dhe QMT;
 - Ndërtim i segmentit rrugor Sheshi Shqiponja - Bulevardi i ri -Shkozë, Urat mbi lumin Tirana;
 - Ndërtim i segmentit rrugor Sheshi Shqiponja- Bulevardi i ri, Loti 2;
 - Zgjerimi i superstradës Tiranë - Durrës Faza I dhe Faza II.

- ✓ Ndërtim rruge tip B me dy korsi, ku janë përfshirë kryesisht tip rruge me dy korsi dhe gjërësi që varion nga 10-17 m, duke përmendur disa objekte të rëndësishme në të cilat punohet me ritme të parashikuara:
 - Ndërtim rruga Kardhiq - Delvinë Loti 8 (Sistemimi dhe Rivitalizimi i Skarpatave);
 - Zgjerimi i rrugës Elbasan - Qafë - Thanë (Faza I – Faza VIII);

- ✓ Ndërtim rruge tip C2 me dy korsi, janë përfshirë kryesisht tip rruge me dy korsi dhe gjërësi që varion nga 7.5-10 m, ku po punohet normalisht në:
 - Ndërtim rruga Korçë – Ersekë, Loti 2 pjesa e Dytë dhe modifikim kontrate;
 - Ndërtim rruga Palas – Dhërmi+ modifikim kontrate;Ndërtim i rrugës, lidhja e Autostradës Milot - Morinë me Aeroportin e Kukësit;
 - Rehabilitim i segmentit rrugor Levan - Vlorë (rruga e vjeter) dhe modifikim kontrate;
 - Rikonstruksion i aksit rrugor Maliq-Lozhan i Ri Strelcë;
 - Ndërtimi i rrugës së fshatit Senicë dhe lidhja me rrugën Kardhiq – Delvinë;
 - Përfundimi i punimeve në segmentet rrugore ura e Kranesë Qafë Botë, Ura e Kranesë Ura e

- Gajdarit dhe përmirësimi i segmentit rrugor Shijan Ura e Gajdarit + modifikim kontrate;
- Ndërtim rruga lidhëse e Aeroportit Ndërkombëtar të Vlorës (VIA) - Autostrada Fier Vlorë;
- Sistemim asfaltim rruga Ura e Cerencit - Peshkopi (Peshkopi - Maqellarë), Loti 3;
- Sistemim asfaltim rruga Qafa e Buallit – Martanesh;
- Ndërtim rruga Berat - Ballaban, Loti 3, loti 2, loti 1;
- Rikonstruksion i rrugës së vjetër Kombinat- Ndroq - Plepa, Loti 1;
- Zgjerimi i rrugës së Ksamilit;

✓ Sinjalistikë dhe Siguri Rrugore

- Eleminim i pikave të zeza (Black Spots), në rrjetin rrugor kombëtar;
- Përmirësim i sinjalistikës horizontale, vertikale dhe pajisjeve të sigurisë rrugore në akset e Rajonit Qendror, LOTI 2 (2023);
- Eleminim i pikave të zeza (Black Spots), në rrjetin rrugor kombëtar 2023;
- Përmirësim i sinjalistikës horizontale, vertikale dhe pajisjeve të sigurisë rrugore në akset e Rajonit Verior, të
- Rajonit Qendër Perëndim, Rajonit Jugor, të Rajonit Qendër Lindje;

✓ Ndërtim rruge A e modifikuar :

- Ndërtim rruga Porto Romano Durrës, Loti 3;
- Plotësimi i punimeve të mbetura në aksin Porto Romano Durrës, Loti 3;

Tavani buxhetor i programit për shpenzimet kapitale me financim të huaj përbën 25,2% të buxhetit të rishikuar 2024 për shpenzimet kapitale me financim të huaj. Projektet prioritare me financim të huaj janë:

- Përmirësimi dhe rehabilitimi i Urave;
- Ndërtim segmenti rrugor Qukës – Qafë Pillocë;
- Ndërtim ByPass i Tiranës;

Tavani buxhetor i programi buxhetor "Furnizimi me Ujë dhe Kanalizime ", përbën 21,1% të totalit të buxhetit të rishikuar të MIE për shpenzimet kapitale.

Tavani buxhetor i programit për shpenzimet kapitale me financim të brendshëm përbën 23.5% të buxhetit të rishikuar 2024 për shpenzimet kapitale me financim të brendshëm. Projektet prioritare me financim të brendshëm janë:

- ✓ Ndërtim sistemim kanalizime dhe impianti i trajtimit të ujrave të ndotur Bulqizë;
- ✓ Ndërtim i rrjetit të kanalizimeve të ujërave të zeza KUZ, fshatrat Gjoricë e Sipërme dhe Gjoricë e Poshtme Njësia Administrative Gjoricë;
- ✓ Ndërtim i linjës kryesore të ujësjellësit dhe rrjetit shpërndarës për fshatrat e njësisë administrative Xibër, Bashkia Klos;
- ✓ Ndërtim ujësjellësi Rajonal nga burimet e Përroit të Lopës dhe Gurrave të Ketës, Faza I;
- ✓ Ndërtim rrjeti kryesor furnizimi me ujë i fshatrave të Njësisë Administrative Maqellarë dhe rrjeti shpërndarës fshati Kërçisht i Sipërm;
- ✓ Ndërtim i linjës së furnizimit me ujë të pijshëm Gurra e Epërme-Luzni-Peshkopi;
- ✓ Furnizimi me ujë të pijshëm për fshatrat Brezhdan dhe Ushtëllencë, nj.A.Qëndër Tomin, Faza II;

- ✓ Ndërtim i Ujësjellësit Rajonal për njësinë administrative Golaj, për fshatrat Dobrunë, Qarr i vogël, Golaj, Nikoliq dhe Vlahen, Bashkia Has;
- ✓ Furnizimi me ujë i zones Mjede dhe Shelqet, Bashkia Vau i Dejës, Bashkia Vau i Dejës;
- ✓ Rikonstruksion i ujësjellësit në 15 fshatrat e njësive Administrative Novoselë;
- ✓ Ujësjellësi-Zona e Ujit të Ftohtë dhe Lungomares, Rrapi Uji i Ftohtë-Shkolla e Marinës;
- ✓ Përmirësime të sistemit me ujë në lagjet ish-fabrika e Çimentos-Partizani-Karabash dhe rindërtimi i ujësjellësit në Babicë të vogël, njësia administrative Qendër Vlorë;
- ✓ Rikonstruksioni i Ujësjellësit Gose;
- ✓ Rikonstruksion i magjstralit kryesor dhe rrjetit të ujësjellësive të fshatrave Lekaj, Harizaj, Kryeluzaj, Zambisht, Okshun dhe Munshnik të njësive administrative Lekaj
- ✓ Furnizimi në zonat bregdetare, Plazhi i Gjeneralit – Bardhor – Karpen – Synej, Bashkia Kavajë - Varianti I,
- ✓ Rikonstruksioni i rrjetit të ujësjellësit në fshatin Shënavlash, njësia administrative, Rrazhbull;
- ✓ Rikonstruksion i ujësjellësit, rruga Kongresi i Përmetit, (NSHU), J.Dyli, Haxhire, Elbasan; linja kryesore STP -Byshek-depo Mlize, Shushicë; linja kryesore stp Bujqës- depo Mjekës;
- ✓ Ndërtim ujësjellësi rajonal Cerrave&Dardhas - Burimet e Gurrasit;
- ✓ Ujësjellësi i Mokrës Faza e II-të;

Tavani buxhetor i programit për shpenzimet kapitale me financim të huaj përbën 23,4% të buxhetit të rishikuar 2024 për shpenzimet kapitale me financim të huaj. Në projektet që po implementohen me burim financimi të huaj nga donatorët, përmendim:

- ✓ Infrastruktura Bashkiake, III, IV, V;
- ✓ Programi Kombëtar i Modernizimit të Sektorit të Ujësjellës Kanalizimeve;
- ✓ Projekti i rikonstruksionit të rrjetit të brendshëm për ujësjellësin e Bashkisë Durrës;
- ✓ Projekti i kanalizimeve Tirana e Madhe;

Tavani buxhetor i programi buxhetor " Transporti Detar ", përbën 17,3% të totalit të buxhetit të rishikuar të MIE për shpenzimet kapitale.

Tavani buxhetor i programit për shpenzimet kapitale me financim të brendshëm përbën 26,4% të buxhetit të rishikuar 2024 për shpenzimet kapitale me financim të brendshëm. Projektet prioritare me financim të brendshëm janë:

- ✓ "Porti i Ri Tregtar i Integruar i Durrësit në Porto Romano-Faza 1"

Tavani buxhetor i programit për shpenzimet kapitale me financim të huaj përbën 0,07% të buxhetit të rishikuar 2024 për shpenzimet kapitale me financim të huaj.

Tavani buxhetor i programi buxhetor " Transporti Hekurudhor ", përbën 8,3% të totalit të buxhetit të rishikuar të MIE për shpenzimet kapitale.

Tavani buxhetor i programit për shpenzimet kapitale me financim të brendshëm përbën 1.5% të buxhetit të rishikuar 2024 për shpenzimet kapitale me financim të brendshëm.

Tavani buxhetor i programit për shpenzimet kapitale me financim të huaj përbën 30,4% të buxhetit të rishikuar 2024 për shpenzimet kapitale me financim të huaj. Projektet prioritare janë:

- ✓ Hartimi i Projektit preliminar Rrogozhinë – Pogradec - Lin (Kufi me Maqedoninë e Veriut);
- ✓ Zbatimi i Projektit të linjës hekurudhore Terminali i transportit publik - stacioni i trenit Tiranë (4km), si zgjatim i linjës hekurudhore Durrës – Tiranë;
- ✓ Zbatimi i projektit inxhinierik dhe arkitektonik i godinave të stacioneve hekurudhore Durrës - Tiranë TTP – Rinas, Aeroport’
- ✓ Zbatimi i punimeve ndërtimore për elektrifikimin e linjës hekurudhore "Durrës - Tiranë dhe ndërtimin e linjës së re hekurudhore për në aeroportin e Rinasit;
- ✓ Studim i Fizibilitetit dhe Projekt Ide për lidhjen hekurudhore Durrës – Prishtinë;
- ✓ Zbatimi i projektit "Rehabilitimi i linjës hekurudhore Durrës-Rrogozhinë"
- ✓ Zbatimi i projektit "Rehabilitimi i linjës hekurudhore Vorë - Hani Hotit"

Tavani buxhetor i programi buxhetor "Mbështetje për Energjinë", përbën 5,5% të totalit të buxhetit të rishikuar të MIE për shpenzimet kapitale.

Tavani buxhetor i programit për shpenzimet kapitale me financim të brendshëm përbën 0,7% të buxhetit të rishikuar 2024 për shpenzimet kapitale me financim të brendshëm.

Tavani buxhetor i programit për shpenzimet kapitale me financim të huaj përbën 20,8% të buxhetit të rishikuar 2024 për shpenzimet kapitale me financim të huaj. Projektet prioritare janë:

- ✓ Rehabilitimi i Hidrocentralit të Fierzës (DKT);
- ✓ SCADA (Zgjerimi i sistemit SCADA në godinën Qendrore të OSHEE);
- ✓ Rikonstruksioni i Nënstacioneve 110kV në rajonet (Tiranë, Durrës dhe integrimi i tyre në sistemin Scada;
- ✓ Ndërtimi i Nënstacionit Kamëz (Valias) me fuqi 2x40MV (ONAN/ONAF) 110/20KVA dhe ndërtimi i dy fiderave 20kV (V4, V5P);
- ✓ Për Reagimin ndaj Krizës së Pandemisë Covid 19/ Ndërtimi i N/Stacionit 110/20 kV, Nëntokësor, QENDËR në Tiranë , Komponenti 2 Programet e tjera buxhetore, zënë një peshë rreth 0,72% të buxhetit të rishikuar të vitit 2024 për shpenzimet kapitale;
- ✓ Programi i Investimeve për Shpërndarjen e Energjisë Elektrike I;
- ✓ Rehabilitimi i rrjetit elektrik Himarë – Dhërmi;
- ✓ Instalimi i matësve inteligjent në nënstationet e sektorit të Shpërndarjes;
- ✓ Konvikte të rinovuara me efikasitet të energjisë (faza e dytë) Qyteti Studentit nr. 1;
- ✓ Fuqia Energjitike dhe Siguria e Digës në Kaskadën e Drinit.

6. NDRYSHIMET NË BUXHET

Mbështetur në analizën e performancës së zbatimit të projekteve në vazhdim dhe ecurisë që do të kenë projektet e reja prioritare 2024 që janë në procedurë prokurimi aktualisht, MIE do të kërkojë rritje të performancës buxhetore dhe financiare, përtej planit të rishikuar të buxhetit për vitin 2024. Në lidhje me argumentimin për ndryshimet në buxhetin e rishikuar të vitit 2024, nga njësitë e varësisë janë raportuar kërkesa buxhetore shtesë, si rezultat i krijimit rishtazi të detyrimeve të prapambetura për periudhën raportuese dhe parashikimit për shmangien e krijimit të detyrimeve të mëtejshme gjatë periudhave të mëvonshme 2024. Në nivel programi dhe në nivel artikulli, kërkesat shtesë paraqiten si vijon:

	Programi Buxhetor	Artikulli	Kërkesa shtesë në lekë	Argumentimi
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	602	1,823,700,000	Vendosje sekuestro konservative për shlyerje të detyrimeve gjyqësore të formës së prerë
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	606	56,000,000	Rimbursim i shpenzimeve të varrimit për shtetasit shqiptare që vdesin jashtë vendit
04560	Transporti Ajror	231 (01)	3,200,000	Blerje canta e investigimit në detyrë
04520	Transporti Rrugor	231 (01)	2,329,071,892	Detyrime të prapambetura të krijuara rishtazi në 4 mujorin e I, të vitit 2024
06370	Furnizimi me Ujë dhe Kanalizime	231 (01)	2,176,876,882	Detyrime të prapambetura të krijuara rishtazi sipas autoriteteve kontraktore që tashmë të përfunduara dhe me fatura të dorëzuara në 4 mujorin e I, të vitit 2024.
06370	Furnizimi me Ujë dhe Kanalizime	231 (02)	1,210,635,184	Projektet me financim të huaj

7. PËRFUNDIME

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë është e angazhuar maksimalisht në realizimin e buxhetit të vitit 2024 dhe mos krijimin e detyrimeve të prapambetura.